

Dashuria e Mid'hat Frashërit është shpuzë e amshuar, e mbuluar me hirin e jetës. Ai i caklon dhe i shpupurit me penën-pupël gacat që valëzojnë në një dritë të gjelbër dhe i derdh me mjeshtëri dhe art në letrat e tij. Dashuria e tij është e çiltër, e vetvetishme, e magjishme, emocionale, e ndershme. Ai e ka provuar atë me pasion më tepër se një herë, si njeri i lirë dhe i kulturuar, atë ndjesi të brendshme e të patjetërsueshme njerëzore, atë prush që djeg e shqerr, si një dritë dhe terr, si shend e vuajtje e bukur, si një poezi e si një dramë, si forcë njerëzore që e çliron dhe e ndryshon botën.

URAN BUTKA

LUMO SKËNDO

Përpara shegës me lule

Prozë dhe letra dashurie të pabotuara

(fq. 2)

Çfarë mund të ndryshojë
lexuesi i ri?

Agim Baçi

(fq. 9)

Ankthi i vdekjes në prozat “Prilli i thyer” dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”

Petrît Palushi

(fq. 12)

Në prozat “Prilli i thyer”, të Kadaresë dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, të Markesit, rrëfëhet për drama komplekse të personazheve mbizotërues të këtyre veprave, pikërisht pas njohjes së tyre me faktin e tillë: vdekja do t'i mbërthente në kohën sa më t'afër...

Kur vjen dashuria

Feride Papeleka

(fq. 14)

Duke filluar nga poema *Iliada* e Homerit, poezia ia ka lënë vendin kryesor dashurisë. Në teatër gjithashtu fatet njerëzore përmbledhen shpesh në fjalën dashuri...

15 vjet më parë u nda nga jeta poeti

Një prill për Fredin

Ismail Kadare

(fq. 17)

Për Frederik Rreshpjen, poetin shqiptar të shekullit XX, gjithçka ka qenë e vonuar. E tillë, e vonuar, ka qenë hyrja dhe njohja e tij në letrat shqipe, pastaj rikthimi, më saktë njohja e dytë, pas fatkeqësisë komuniste, që ka qenë në radhë të parë fatkeqësia e tij. E kështu me radhë: vlerësimi i tij, që vazhdon të jetë i munguar, e bashkë me të gjithçka për të cilën ka nevojë një poet...

Dimri i dhimbjes së Rreshpjes

Enver Kushi

(fq. 16)

Frederik Rreshpja shkoi duke mos lënë, si në baladën e moçme shkodrane, një sy apo një krah jashtë. Rreshpja është i tëri mes nesh, më i gjallë se kurrë.



DIANA KASTRATI:
Objektivi ynë, studimi dhe botimi e universit të Arbëreshëve të Italisë dhe të Zarës së Kroacisë

Intervistë dhënë gazetares

MIMOZA HASANI PLLANA

(fq. 10)

**FANTAZMA NË
TRYEZËN E SHKRIMIT**

Cynthia Ozick



(fq. 22)



Rreth shtatë poezive apo poemës së parë shqipe për shtatë mëkate mortare të Gjon Buzukut

DHJETË TEKSTE TË TJERA TË BUZUKUT

Anton Nikë Berisha

(fq. 7)

Duke lexuar veprën “Meshari” të hartuar nga Gjon Buzuku, përveç katër Psalmeve origjinale, tashmë të përmendura e të analizuar në pjesën e dytë të studimit, kam veçuar edhe këto dhjetë tekste që duhet të jenë hartuar nga ai ose janë përshtatje të lira të tij.

BIBLIOTEKË

Alisa Velaj

Arie e një të shastisur

(fq. 19)

Muriel Spark

Viti i parë i jetës sime

(fq. 20)

Philip Larkin

E gjelbra është një lloj brengje

(fq. 18)

Brikenë Ceraja-Beka

Kam me fjetë mbi andrrën tane

(fq. 15)

Gertruda shekspiriane ose skllavëria ndaj pasioneve

prof.dr. Klara Kodra

(fq. 13)

Gjenialiteti i Shekspirit qëndron në krijimin e karaktereve të gjallë që mishërojnë mijëra nuancat e së mirës dhe të së keqes.

Asnjë skematizëm s'ka në këto karaktere, ku thelbi social dhe thelbi individual shkrihen në mënyrë të harmonishme, ato kanë larminë dhe vitalitetin e jetës.

Lumo Skëndo

PËRPARA SHEGËS

ME LULE

Prozë dhe letra dashurie të pabotuara

DASHURIA

Me rastin e Ditës së të Dashuruarve po botojmë në gazetën *ExLibris* disa proza poetike të Mid'hat Frashërit për dashurinë, botuar te përmbledhja me tregime *Hi dhe shpuzë*, viti 1915, si dhe disa nga 60 rrëfimet e tjera të tij të panjohura, të zbuluara në arkivat shqiptare dhe europiane e të botuara në veprën e zgjedhur të Mid'hat Frashërit nga Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”. Gjithashtu, po botojmë edhe disa letra dashurie të Mid'hat Frashërit dhe të dashurave të tij, që përbëjnë një kulm të letërsisë epistolare erotike.

Dashuria e Mid'hat Frashërit është shpuzë e amshuar, e mbuluar me hirin e jetës. Ai i caklon dhe i shpupurit me penën-pupël gacat që valëzojnë në një dritë të gjelbër dhe i derdh me mjeshtëri dhe art në letrat e tij. Dashuria e tij është e çiltër, e vetvetishme, e magjishme, emocionale, e ndershme. Ai e ka provuar atë me pasion më tepër se një herë, si njeri i lirë dhe i kulturuar, atë ndjesi të brendshme e të patjetërsueshme njerëzore, atë prush që djeg e shqerr, si një dritë dhe terr, si shend e vuajtje e bukur, si një poezi e si një dramë, si forcë njerëzore që e çliron dhe e ndryshon botën.

Qysh në tregimin e tij të parë *Përpara shegës me lule*, shkruar më 1898, kur ishte 18 vjeç, shihet prirja e tij për një letërsi ekzistencialiste, duke u shfaqur si një pararendës i letërsisë moderne europiane, mandej me prozat poetike si një nga themeluesit e prozës së shkurtër artistike, si një poet i dashurisë dhe i paqes. Më në fund, si një filozof i dashurisë.

“Dashuria, - shkruan ai, - është kondita e jetës. Po të mos ekzistojë ajo, shkatërrohet lidhka në mes të gjymtyrëve të njeriut, familjes dhe njerëzisë, zhduket shija e gjallërisë dhe e jetës. Pa dashuri s'ka entuziazëm, s'ka shpesë, nuk kryhet asnjë vepër. Entuziazmi dhe shpesa, bijat e dashurisë së sinqertë dhe të thellë, duhet të jenë si ata trëndafilat mëngjesi që çelin çdo ditë të rinj, si ato lulet që mbyllen natën, por hapen nën rrezet e para të diellit”.

Kështu e ndien dhe e jep Mid'hati dashurinë e tij.

Edhe në letrat e të dashurave të tij shpaloset dashuria e tyre e jashtëzakonshme për të, por edhe për vlerat e tij. Letrat e dashurisë mes intelektuales rumune Angela Romano dhe Mid'hatit dokumentohen për 24 vjet me radhë, pak më tepër se letrat e dashurisë mes Balzakut dhe princeshës Hanska, dhe me një patos të papërshkruar. Po ashtu letrat e për Ninon, Emën, Elsën, Lolottën, të dashurat e tij të përjetshme.

Lexuesi le t'i gjykojë dhe t'i shijojë vetë.

Uran Butka

Dashuria

Stamboll, 1898-1899

PËRPARA SHEGËS ME LULE

Nga Këzëll-Topraku në Eren-Qoj shkonja shpesh dhe kurdoherë kthehesha më këmbë. Ajo orë ecjeje, që në dekor i njihja çdo çip, çdo pikë, ishte për mua një zbavitje me një pëlqim të madh.

Vetëm sot jam i pikëlluar, pakëz si më tepër se herët e tjera. Tek Murati kisha qenë prapë dëshmitar i mihjes, i thirrjeve të ashpra me fjalë të vrazhdëta. Asija 1 , kushërira ime më e madhe, buçiti në një shtrëngatë qortimi e sharjesh kundër Muratit, duke e gjetur këtë, tek e shikoja, si një detar brenda në limer të qetë, po edhe jo pa një frikë, të përzier me atë dëshpërim që na jep pamja e një sëmundjeje fizike.

Pa arritur në Fenerjoll, në të djathtë, shega me lulet e kuqe, që zbukuronte shtëpinë, qoshkun e drunjtë dhe të gjitha foletë e njerëzve, shega, them, më çeli sytë si një mikeshë e njohur dhe nuk munda t'i shkonja përpara pa e përshëndetur. A duhet edhe të them që ishte vjeshtë, koha afër të ngrysurit? Qarkrrethina mbarë, që më shtoi pikëllimin, duke mejtuar skenën që kisha kapërcyer qëparthi, nga një shkallë te tjetra shtigjeve të mejtimit, u gjenda përpara zemrës sime, ballë për ballë me veten time. Ndjenja e mëshirës për Asijen, që e shihja kurdoherë në përlëshje fjalësh, herë me të shoqin, herë me t'ëmën, e kësaj Asije, që me gjithë të metat e saj më ishte aq e dashur, më bëri të më vijë keq për të, të kuptoj se mungesa e butësisë së zemrës, e lidhkave të afeksionit, është padyshim fatkeqësia më e rëndë për njeriun. Edhe befas një re e zezë më shkoi në qiellin tim: a nuk gjendem edhe unë në një zbrazëti, pa mbështetje dhe dhembshuri, pa qëllim, pa një ngrohtësi, ku të zbutet akulli i jetës.

Ky mendim më solli një hidhërim, se më gjente vetëm, të dobët dhe pa fuqi, përpara këtij labirinti, atij kaosi që i themi Uni. Edhe Uni me trembte, më dukej një gjë e thellë dhe e zezë, si nëndhesat e shtëpive të mëdha, kur isha i vogël.

Kisha kapërcyer stacionin e Fenerjollit, shtëpitë e fundit të kësaj mëhale, dhe kisha marrë shtegun drejt skajit të Gjoztepes. Isha në atë lëndinë të madhe si një bjeshkë, që zbret me ngadalë dhe butë drejt Marmarasë në një horizont

të gjerë dhe të shkëlqyeshëm. Kur, përnjëherë, një qetësi, një ngushëllim zbret në të thellët e Unit. Fytyra e Mimikës, e kësaj motre të njomë më ishte shfaqur, për të më thënë që kisha në zemër një dashuri të vërtetë për këto krijesa, jo sot, por qëkurse fati m'i kishte dhënë për shoqe në jetë. Edhe kjo fytyrë me ato ide ndriçuan korridoret e labirintit si një rreze në atë kaos. Tani shihnja, kisha fuqi dhe gëzim.

Shkruar herën e parë më 1898-1899 në Eren-Qoj (Shënim i autorit)

Vjeshtë, 1905

ASAJ

I

Si kombet me vetija e me mendime të thjeshtë, q'i falen një fytyre gdhendur në gur a në dru; si kombet më të qytetëruara, që rrinë me orë dhe luten përpara një fytyre bërë me ngjyrë vaji a dy copëra drurë të bashkuar; si ata kombe që marrin me muaj udhë që të venë e t'i falen gurit të zi; si ata të moçmit, q'i falen diellit, zjarrit, shikonin me adhurim të thellë yjtë dhe bëheshin thërorë për perëndit'e për perëndeshat, a si ata që dhe sot shtrihen e shtypen nën qere të Budës; ashtu dhe unë, o e bukura ime, dua t'u falem dy yjeve që janë më të bukur se të gjith yjt'e qiellit, dy yjve që janë syt'e shkruar të tu dhe të bëhem hi, o e dashuria ime, nën këmbët tënde vogëloshe!

II

Prill, 1906

N'është vërtet se zemra jote s'rreh kurrë për mua - ashtu si ke dashur të më duash, - në është vërtet se fytyra ime nuk zë asnjë vend në ëndërrimet e tua, pse, o e bukura ime, kur më sheh, ngadalëson çapnë, pse më lëshon vështrimin' e atij syri tënd të shkruar?

Nuk e di ti si më buçet dhe më zjen gjaknë ay vështrimi yt kaq i qetë dhe i ftohtë? Nuk e di ti si më çpon zemrën ay vështrimi ngjyrë qielli?

Vështrimi yt është si një shtizë në dorë të një djali që lot me një zog; vuajtjet e shpesit i heq dhe zemëra ime. Të lutem

pusho, pushoje këtë lodër të gjakme!

Po ç'them unë! shtjermë, shtjermë syt' e tu, se vështrimi yt, o e bukura ime, m'i thjeshtë se frymë e Jehovajt, i jep gjëllim shpirtit tim.

III

Shënëndre, 1906

Pse ikën ashtu nga unë? nuk e di ti që dashuria është me krahë dhe m'e shpejtë se vrapit yt?

Dashuria ime të është qepur si hija. Kudo që të vesh, të ka për të rënë pas; kudo që të jesh, do të të dalë përpara, dhe kur të na ndajë një mërgim i madh, hija ime prapë të ka për të ardhur pranë.

Malet, fushat, as njerëzit s'na kanë për të ndarë, se shpirti im është qepur pas shpirtit tënd, se trupi im të ka për të kërkuar gjithnjë. Edhe vdekja kur të më marrë nga kjo botë, edhe ahëre hija ime - e dashura e tmerruar - ka për t'ardhur të të gjejë në të mugëtit e në t'errët.

Edhe kur për ty - ah, dua që të jetë shumë e largme - do vij' ora që të shuhen ata sy q'i dua kaq, dhe të bëhet hi ay trup i bukur, edhe ahëre, o zemërkeqe, mos pandeh se do të shpëtosh nga ndjekja ime; shpirti im të ka për t'ardhur gjer në varr, se shpirti im është qepur pas shpirtit tënd dhe trupi im ka për të të kërkuar gjithnjë; ahëre, brenda në varr t'errët e të ftohtë, eshtrat do të të dridhen, se në dashuri do të jem gjithnjë besnik!

IV

1908

Më pyet sa është' e thellë dhe a është e përjetshme dashuria ime.

Ahëre syt' e tu, ata sy të zez q'i dua kaq, marrin një shkëlqim, një vështrim të ri, edhe buza jote ka një të qeshur të hidhur.

Pse, o e dashura ime, pse lë të hyjnë të tillë mendime të hidhur n'atë kokë të bukur?

Nuk' e di ti që çdo gjë në këtë jet' është e vdirshme? Nuk e di ti që çdo gjë mbi këtë dhé ka një fund?

Prapsi, prapsi, këto mendime. Mos i përsërit këto pyetje.

Të dua me gjithë shpirt, me dashuri të thellë; sot të dua sa për një jetë të tërë. Mos prish gaz' e sotmë, duke menduar të nesërmen e errët.

Mos më pyet më sa është' e thellë dhe sa është' e përjetshme dashuria ime!

V

Gusht 1909

Më pyete pse të dua dhe unë qesha.

Qesha, ama tani po mendohem dhe them: Pse të dua?

Të dua për atë të qeshur të bukur, kur të shkëlqen syr' i kthjelltë nën ballë të qëruar; të dua për ato leshra ku është pështjellë gjithë thellësi e natës, dhe për atë vështrim ku këndohet gjithë gaz' i ditës, për atë vështrim q'është si një yll i lumturisë; të dua, se kur flet, ay zë më zgjon në zemrën time gjithë zërat e fshehtë të shpirtit; të dua se pranë teje, e ndiej veten time të madh dhe të fortë, se në dashurinë tënde shoh zbardhëllimin e jetës.

Po të dua se, tekdo, me gëzim të fatbardhësisë, a në t'errët të helmit, se në qeshje të mëngjesit, në tym të të mugëtit, se në ngjyrë të lules a në përkëdhelje të veriut, tekdo, o e dashura ime, ty të gjej dhe ty të shoh; të dua se edhe kur zbres në thellësi të shpirtit dhe në fund të zemrës, edhe atje thellë të gjej.

Eren-Qoj, 5 mars 1912

EJA MOTËR

Eja motër, të dalim në kopësht, se erdhën kohët e mira! Nuk e sheh që marsi na pru ditët e bukura? A po sheh se qysh qielli duket m'i ëmbël, deti m'i vakur dhe malet atje larg, a i sheh se qysh kanë një ngjyrë më të dashur dhe duken më t'afërt?

Eja motër, se qershitë janë plot lule! I mban mend këto lule, kur i tërë kopshti mvishej me të bardhë? Shkuan dhjetë vjet q'ahere! E mban mend, kur hipnje në drurët dhe qeshnje me mua, kur s'të gjenja dot? Se ishe dhe ti e bardhë si dëbora veshur dhe nuk shquanje nga lulet.

Eja motër, të shohim qershitë! Vërtet këta më s'janë ata drurë; ata u thanë dhe humbën. Po lulet janë gjithnjë ato lule!

5/19 vjesht' e parë

AH, PO BIE SHI PRAPË !

Eja, mike, se po bie shi!

Më duket sikur po qan qielli, sikur po derdh lotë të hollë. Edhe zemra ime sot po qan. Jam vetëm; lotët e qiellit rrjedhin jashtë qelqevet dhe po ndjej të ftohtë brenda në zemër.

E mban mend, mike, kur ishim bashkë sa shumë' e donim shiun? E mban mend gazin që ndjenim afër dritares, kur binin pikat e mëdha të shiut? Ti i prisnje ato ditë, se e dinje që më

pëlqenin; i prisnje ato ditë, më prisnje mua.

Ahere, kur bota mbytej me lotë, ne ishim të gëzuar; ahere, kur bota mbulohej me ujë të ftohtë, ne kishim të nxehtë në zemër.

Po tani, nga kjo gjysm’ odë shikoj pikat, që po kullojnë dhe po mërdhi.

4/ 17 vjesht’ e tretë AFRËDITA E MILO-s		
Fidia më s’pat prehje. Gjumi më s’ia çlodhi sytë. Ngrënies më nuk i gjeti shije. Një ethe çdo ditë i digjte dejtë. Përpara shkëmbit të mermerit si shkumb’ e bardhë, Fidia po punon dhe po mejtohet. Muskujt e tij po i xhonglohen nën çekanin e rëndë, një djersë ethesh po i kullon nga ballët, një zjarr po i ndriton sytë. Edhe më s’pat prehje. Çdo ditë nga shkëmbi po dilte një formë e re. Punoi, punoi, akoma, me zjarrin e shenjtë. Kërkonte bukurinë, gjithnjë të ëndërruar, kurrë të parë. Kur u mbarua vepra, Fidia e shikoi me syt’ e nxehtë, me ata sy që s’ishin lodhur kurrë. E shikoi akoma, edhe një herë dhe i mbylli sytë, se guri i ftohtë iu duk i gjallë, me një shpirt, me një frymë, që s’i kish pandehur. I lumtur Fidia, m’i lumtur se Hyji! Se mendja jote polli bukurinë e pavdekur, gruan, gjithnjë të dëshiruar, kurrë të gjetur.		

25 prill 1915 DON ZHUANI		

Don Zhuani po e mbaronte jetën. Kishte dashur akoma të ndjente gazet e miqësisë, dehjet e dashurisë, të kishte ende një kujtim prej jetës së tij edhe gjer në varr.

E tërë një jetë e gjatë e përmbledhur në një fjalë: dashuri. Kishte dashuruar dhe ishte dashuruar. Sa gra kishin psherëtitur për të, sa gjire çupash kishin rrahur!

Pa iu shuar ata sy, desh të hidhte një vështrim mbi gjithë fytyrat e dashura: blonde, brune, sy të zinj si nata e thellë, sy të kaltër si qielli me diell;u përpoq të ndjente përkëdheljen e frymës së tyre, drithërimën e trupit të tyre. “Në dehjen time kam pandehur se të gjitha gratë do të jenë të mijat. Kam dëshiruar, që gjithë gratë të mblidhen në një, ose që që dashuria ime të shfaqet nën një numër të pafund”.

Dëgjoni miq, kam qenë i lumtur dhe po vdes i lumtur. Nuk kam keqardhje për jetën e shkuar, se s’më mbeti e zbrazur.

Edhe disa minuta do të shihte spektret e fytyrave të adhuruara.

Pastaj një natë e thellë, një re e zezë,një kurrgjë...

Ahere Don Zhuani u ngrit mbi shtrat si një statujë mermeri përnjëherë e ngjallur, që zgjohet mbi themelin e tij. Të zbehtit e mortjes i ishte përzier me pikëllimet e iluzioneve gjysmë të shuara.

N’ODË TË ASAF MUHAMERIT		
Edhe një herë një dëshpërim më zë shpirtin, një pikëllim më pushton me pluhurin e zi të tij. Them: pse kjo rrojtia ime, për ç’qëllim ky mundim i jetës? Kjo lodhje e udhës pse po zvarritet? Ah, kur një hije e zezë e ndalon njeriun të shohë një bukuri në udhë; kur sytë kërkojnë një ideal, një gjë të bukur, të mirë dhe të madhe; kur çdo gjë, në turbullim të dëshpërimit i duket e kotë dhe e zbehtë, ahere jeta është një barrë, që shtyp shpirtin dhe fik mendjen. Edhe kërkoj një shpëtim nga këto veriga të rënda.		

Në Skelë, Guirgevo, 3 gusht 1915 BARIU		
Bariu i ri, i hijshëm, si një lis i ri në mal të egër, me gjethe të njoma të blerta në të çelur e të aromta,po kullot bagëtinë. Është i lumtur se punët i kanë vajtur mbarë; shqerrat s’i janë sëmurur dhe delet e tij e japin qumështin me shtambë. Mbështetur në një bredh të ri, në shullë të butë, po shikon kopenë e tij i shtrirë; është i lumtur djaloshi, se rudet dhe kaleshet janë të mbara. Edhe po i bie fyellit. Bari, bjeri fyellit! Nuk e sheh si është moti i përtëritjeve, nuk sheh që veriu po fryn i butë dhe i ëmbël, një frymë miqësore, plot dashuri dhe miqësi? Bjeri, bari, fyellit! Bari i thatë u ngjall, luleve po u qajnë sytë, fluturat po ndjejnë, zogjtë kërkojnë të vegjëlit e tyre, këngët janë plot mallëngjim; veriu i ëmbël po i përkëdhel: Është dashuria që ngjall të vdekurin, që u jep krahë genieve, që u jep këngë zogjeve. Bari i ri dhe i lumtur, edhe ti ke dashuri në zemër. Është kohë përtëritjeje dhe gjallimi. Bjeri fyellit, jepi më fort shpirt		

asaj kallameje, që po e bën të rënkojë e të qajë.

Ah, bari, kur të vijë dimri me thëllimet e tij,kur të fryjë murlani i egër, shpirti dhe dashuria në çdo gjë të ngrijë, ahere dhe fyelli do të jetë i shurdhët ; ahere edhe drutë, fluturat, zogjtë, edhe lulet do të jenë pa shpirt e të vdekura!

6 nëntor 1915 DASHURIA JE TI VETË, O GRUA!		
Ngreu, mik! Nuk e sheh q’është koha e gjerimeve dhe e shpresës? Shiko jetën, shikojë në sy, mos u tremb. E sheh sa e butë dhe e mirë q’është? Të dukej e egër dhe e shëmtuar, ahere kur kishe frikë. Shikojë jetën dhe duaje. Oh, kjo frymë që më jep shpirt, kjo dritë që më ngjall! Dëgjo mik, nuk shoh më gjë të shëmtuar, çdo vend po më duket e qeshur. Eja, shpresë, bëmë shok. I mbështetur tek ty, dua të eci mbi det, mbi këtë dhe’, që nuk më dëbojnë më. Një mik, duke vdekur, më la këtë kartë: “Po vdes, edhe pak mend do të gëzoj dritën; po e shoh që t’errëtit e natës po më qaset. Më duket se rronja për dashurinë. S’doja gjë tjetër në jetë, po të dashuroj dhe të më dashurojnë, t’adhuroj dhe të m’adhurojnë. Zemra në kraharorin tim s’ishte për mua, po për dashurinë time. Zemra, fryma, shpirti, sytë, doja të gjitha të ishin për gruan e dashur”. Dashuria është lumturia për mua. Pse lindja, pse rrojtia, pse vuajtja, nuk vlejné, kur nuk kanë dashurinë? Mike, kjo është dashuria; është fryma e saj, që ka rënë mbi çdo gjë. Edhe dashuria je ti vetë, o grua! Ai pylli i malit janë leshrat e tua; në qiell dhe në liqen shoh syt’ e tu; aromat e verës janë fryma jote dhe bukurinë ky mëngjes i adhureshëm e merr nga buzëqeshja jote.		

EJA, MIKE!		
Eja, se janë ditë të bukura! O frymë e ëmbël e një mëngjesi vere! O lumturi! Shiko, mike, sa i kthjellët e i dashur është qielli!E sheh këtë luadh kaq të qeshur? Atë liqen të qetë e të kulluar dhe këtë pyll të thellë, t’errët e të dendur? Më vjen sikur po rroj për herën e parë. Ishin edhe dje, qenë dhe vjet këto bukuri? Lermë të shkoj, të iki nga sytë dhe nga krahët e tu, se më duket janë hije, s’janë të vërtetë. Po ç’them unë. Nëmi, nëmi ato buzë! Çeli ata krahë dhe shikomë brenda në sy! Dehmë! Dua që sot, nëse ka shpirt zemra, të të dua, të të dua kaq fort, sa kur të vijë dita dhe të bëhet hije kjo dashuri, ahere të adhuroj kujtimin tënd.		

Calimanesti, 6 korrik 1916 VJERSHËTORIT		
Në të vënçin mënjanë kurorën e florinjtë të një mbreti dhe m’anë tjetër një rreth hyjnor, mbaj këtë të fundit, o vjershëtor, dhe mos e këmbë me të parën. Këndo me atë frymë që të është dhënë prej qielli, shih me ata sy që vështrojnë të fshehtat dhe rrëfejnë ato që të ndjen zemra jote. I lumtur ai vjershëtor, që me fjalët dhe vështrimin e tij na çel një rrugë të re e të shkëlqyer; i lumtur ai që kupton gjithë vuajtjet e gëzimet e zemrës sonë!		

Rupicen Fabrica, 11 dhjetor 1916 UDHËTARI		
Thotë njeriu se nuk ka për ta njohur kurrë prehjen. Çdo mëngjes nis një udhë të re, çdo mbrëmje dielli, që perëndon, e gjen në një vend tjetër. Kur i vihet udhës më këmbë, i duken se kërcinjtë nuk kanë për të qëndruar kurrë. Sytë kurdoherë i kërkojnë një shesh akoma të paparë. Kujton se nuk do të mbarohet udha;pas këtyre lisave, do të duken lisa të tjerë, matanë këtyre maleve, do të zgjatet një fushë tjetër. Trapi i thellë i ngushtuar në brinjët shkëmborë, hija e lisave shekullorë, rrëkeja me shkumë mbi zallet e shkëlqyer, fusha me bar të njomë, shkëmbinjtë me myshk të thatë në gërxhet, ku ka bërë çerdhen shqiponja, mali, që me sy të blertë, pushton një botë të gjerë, për udhëtarin janë vende të dashura. Mëngjesi e gjen me dëshirën e një udhëtimi tjetër, nata e zë me shpresën e mëngjesit. Edhe në gjumë ëndërron sikur kërcinjtë e tij të bërë prej çeliku në udhën e pambaruar, po ecin akoma një të përpjete kurdoherë të re.		

Valovat, 10 janar 1917 ENGJËLLORE		
Mos prit prej meje lëvdata, që nuk i njoh. Emri yt, çdo njeriu do t’i kujtonte ata fluturakët qiellorë, që thonë se rrinë gjithnjë rreth fronit të lartë. Po unë s’kam qenë në qiell, s’kam parë engjëj dhe s’e di si janë. Ty të njoha këtu mbi dhë dhe desha të të njoh edhe më mirë. Ke mjaft mirësi, shumë bukuri. Sytë e tu qeshin bashkë me buzët. Kur fletët e trëndaflilit nxjerrin zërin e ëmbël, duken kaq të këndshme edhe shkëlqimet e zeza! Edhe zemra ime ka nevojë për dashuri, do që të dojë e të vuajë bashkë me të, kërkon më tepër dhimbje. E sheh pra, nuk të desha si një engjëll qielli, por si një grua të dheut, që di të qeshë e të më flasë dhe që ka mbi krye një pyll leshrash të paparfuar. Ajo më shikoi me një vështrim të thellë dhe tha: “Me të vërtetë të dua.” “Më do, se të dua. S’ka një pikë të trupit tënd, që të mos e adhuroj. Ç’është tek ti, më është e shtrenjtë dhe e dashur. Të dua të tërë, grua, kështu si je, me shpirt e me trup”. Jashtë po afrohej agimi. Qielli i kulluar po zbardhej pak nga lindja dhe yjet atje afër veç po verdheshin e veniteshin. Ana tjetër e qiellit rrinte akoma e errët, e thellë, e panjohur dhe e tmerruar. Një erë fryu, veri i lehtë; hyri nga dritarja dhe mbuloi odën. “Er’e ftohtë” tha gruaja. “Po, veri agimi, që sjell ditën e re!” Edhe agimi po përparonte madhështor dhe i shkëlqyer. Zbardhëllima po shtohej me një qetësi që mbushte qiellin e dhenë me një zë të panjohur. Duke u shuar yjet, këndezët së largu hidhnin këngën e tyre tingëllimtare drejt flakës së bardhë që buronte nga lindja, një thirrje gazmore dhe e kthjellët, si nj’ëndërr.		

Valovat, 10 janar 1917 PO LIND DIELLI		
I. Natën çeli sytë dhe më shikoi. Pastaj më tha: kam frikë. Pse ke frikë, e dashura ime? Nuk më sheh se jam pranë teje. Nuk më ndjen në brinjët e tua? ... “Pandeha se isha vetëm” tha. “Vetëm! Kur unë jam këtu? Dëgjo, për mua e tërë bota është plot, se të kam ty pranë. Mund të mbështetemi ne të dy në jetë. Ti më je mjaft.” Qeshi dhe ndriti në errësirë të natës, e lumtur. “Po mbërdhi!” tha dhe pat një dridhje të vogël. Ngrita kokën, u mbështeta mbi bërryl dhe shikova fytyrën e adhuruar, që e ndriçonte një dritë e hollë e ardhur së jashtmi. “Kam në zemër kaq zjarr sa më duket se do shkrij gjithë akujt e maleve. Eja të të ngroh ato buzët e tua me buzët e mia! Eja të të ngroh krahët, kraharorin, gjithë trupin, duart dhe këmbët me frymën time! Shkundu, hidhe brymën e ftohtë. Vish rrobën e dashurisë, që ngroh dhe jep shpirt, edhe më s’do të mbërdhish. Mbeti një copë herë përpara agimit, që po kthjellohej më çdo çast; mori frymë këtë zefir të freskët dhe ndjeu një fuqi të re, një gjak të ngrohtë, që i shkoi në gjithë rrembat e trupit.		
II. “Ngreu, mike, se po lind dielli!”. U zgjua prej gjumit dhe hodhi një sy rreth e rrotull. Ndjeu erën e ftohtë, që po hynte nga dritarja, e zbritur prej qiellit të zbardhur. U ngrit, shkundi leshrat e gjatë ngjyrëgështenjë dhe trupi i saj, një thesar i vërtetë për sytë e atij që di të çmojë një grua të bukur, u rrëfye me gjithë madhështinë e saj.		
III. Dielli akoma s’kishte dalë, po drita ishte bërë e plotë. Asnjë yll më s’kishte mbetur mbi mëndafshin e kaltër, pak i gjelbër të qiellit. Në tokë drizat dhe lulet përpiqeshin të merrnin ngjyrat dhe hijet e tyre dhe, në mes të gjethit të njomë, zogjtë hidhnin shushurimën e tyre gazmore. Po sqëndruam as përpara luleve, as pranë ujit të kthjellët, që binte në pellg të mermertë. Ajo tha: “Të shohim diellin tek del te ai breg” dhe ecëm drejt kodrës. Po shkelnim në një udhë të ngushtë, në mes dy arave të gjelbra: drithi i njomë dhe tërfili kishin akoma rruazat e vesës së natës. Kur arritëm sipër, shikuam me një sy të gëzuar qarkun e gjerë. Tekdo një tokë e nderë, e mbuluar me barin e ri, me fletët e çelura. Atje tej, përkundrejt lindjes, ku formohej skaji i qarkut, një pyll rrëfente njollën e zezë, si lesh i ashpër e i fortë. Në këtë kohë, dielli bëhej gati të dilte. Një dritë e shkëlqyer kishte mbushur anën e lindjes. Të dy po shikonim atë vatër të flakëruar. Përnjëherë shkrep i një shkëndijë, doli një yll i vogël, pastaj një vijë e zjarrtë. “Të fala dritës së parë. Kësaj dite të re!” thirrëm që të dy. Edhe dielli hodhi shigjetat e tij mbi brinjën e dheut të veshur...		

Valovat, 16 janar 1917
NJË DËSHIRË E ÇMENDUR
Nganjëherë kam një dëshirë të çmendur të iki larg, larg teje; të të lë, mos të të shoh më kurrë, ta harroj trupin tënd.
S’është dashuria, që po vdes. Të dua akoma, po të dua dhe të urrej, të dua dhe kam frikë prej teje. Kam frikë prej këtyre verigave, që ke hedhur mbi shpirtin dhe trupin tim, prej kësaj veteje që më pushton. Dua të shpëtoj prej robërie, se më ke robëruar; dua të shpëtoj prej dashurisë tënde, se më ke marrë lirinë. Tani më s’kam asnjë çast prehjeje, se më ke marrë shpirtin dhe trupin, drejt teje rrjedh mendimi dhe gjaku im.
Oh, lemë të iki, të iki tani që të dua akoma, tani që edhe s’jemi armiq. Edhe mos u tremb se lotët e mallit nuk do të mundin ta fshijnë fytyrën tënde nga zemra ime.

Korrik, 1919
LERMË, GRUA!
Lermë grua, lermë të t’admiroj trupin tënd të bërë prej drite dhe shpirti! Dua të ndjej gjakun tënd të rrjedhë nën përkëdheljen time; të shikoj dhe të mos nginjem me këtë kraharor të bardhë. Fryje gjirin, ndehi krahët, se je tërë bukuri dhe ke fuqinë e përjetshme, atë fuqi që rrëmben mendjen dhe zemrën.
Ndehi krahët, fryje gjirin dhe zgjatmë buzët! Por, oh, më tepër se të gjitha akoma, shikomë në sy, se dua të ndiej atë zjarr, atë dritë, që ndez gjakun, atë vetëtimë që çel errësirën; dua që shpirti im të rrijë i qepur tek i yti dhe trupi yt të më rrëmbejë.
Lermë të të shikoj e të t’admiroj, se dua që rrojtja dhe qenia ime të kridhet tek shpirti dhe zemra jote, dua që të humbas fuqinë time në ata krahët e tua të dobët!

Paris, 21 maj 1921
BUKURIA E FJETUR
Sikurdoherë, e fjetur ish aq e bukur, sa edhe e zgjuar, me një fytyrëku qetësimi i shpirtit dhe i zemrës, i kishte një hije më tërheqëse. Kur çeli sytë, një dritë e re ra mbi këtë pafajësi.
Po s’ ishte gazmore sot. Pa u zgjuar mirë, një mendim i hidhur i shkiste mbi fytyrën e këndshme. S’qeshi, si zakonisht. Vuri gjithë frymën e saj në vështrim dhe në buzë.
Edhe pas pak i tha:
- Mi ami, a mund të dojë njeriu më shumë se ç’dua unë?
Pushoi një mend dhe me sytë të kthyer larg, shtoi:
-A pandeh se njeriu e do më shumë Perëndinë?
Ai s’kuptonte që shpirti i saj aq i kthjellët edhe shkëndijat e syve, i ishin dukur kurdoherë si një shpirt foshnjeje. Edhe po e vështronte, mirë e bukur tani, në trëndafil të faqeve dhe në leshrat e zhdredhura.
Por ajo pyeti prapë:
- Më duket se një “Karmelit” e do shumë Perëndinë e “saj”.
Edhe mbi ata sy të mëdhenj, të gjelbër si deti e të thellë si nata, një siguri dashurie po hidhte dritën e saj misterioze.

1 korrik 1923
SIZIFI
Perënditë që s’durojnë njeri të jetë më i fortë se ato, perënditë ziliqare, e dënuan Sizifin në një vuajtje të përjetshme, që ata e gjykonin eshtradërrmuese.
Çdo ditë Sizifi shtyn shkëmbin e rëndë, të rëndin gur, që do t’i thyejë shpirtin. Me ngadalë, pa nxjerrë zë, me vdekje në dhëmbë, ngjit bregun e mortjes. Sytë e tij shikojnë të madhin e ditës, atë që sheh të drejtën dhe të padrejtën. Po dielli rri i fshehtë dhe shtizat e tij hedhin zjarrin e pamëshirshëm.
Përditë ato ngadhënjojnë, se heroi i dënuar po vuan. Keqësia e tyre shfaqet në një buzëqeshje të pamëshirë përpara njeriut të mundur.
Por, atje në majë të bregut, ku ka rrungullisur gurin e rëndë, Sizifi ngre kokën e tij madhështore, zgjat grushtin e lidhur, por jo të bindur. “Ju munda edhe sot, o Perëndi!”
Ngadhënjimi i një çasti ia largon vuajtjet e hequra, se në fitim të tij harron martiren. Në majë të kalvarit që vuan, gjen burimin e fuqisë, plot durim. Edhe çdo ditë, me ngadalë, pa nxjerrë zë, me vdekje në dhëmbë. Sizifi pret triumfin e një mundi mbi perënditë pa mëshirë.

5 tetor 1923
MË KUJTOHET, MIKE
I.
Avulli i flaktë i qiellit ishte ulur mbi malet. Majat e brigjeve, kudo që të shikonte syri, dukeshin të prera në një vijë horizontale. Lartësitë e tyre ishin zhdukur, të pluhuruara prej motit të vjeshtës.
U ngrit me një shpresë: besonte se dielli do t’i sillte buzëqeshje. Po prej kodrave zbrisnin drejt detit vija të ngushta prej dëbore dhe fytyra e dheut rrinte e rrudhosur dhe e vrenjtur.
- Edhe kjo ditë ... Sa herë jam zhgënjyer!
Kishte ardhur këtu për të bredhur dhe për të gëzuar tokën e bukur, të çlodhej prej jetës që i lodhte trurin dhe i brente zemrën dhe t’u jepte liri muskujve të tij. Kishte ëndërruar ecje të gjata në udhë të ngushta në mes të shkëmbinjve, nëpër drurë të thinjosur të pyllit të shpeshtë, që ende s’e kishte humbur gjethen. Tani deti rrafsh dhe të përpjetat që ëndërronte, ishin bërë armiqësore për të dhe i ngjante se kurrë moti s’do të rrëfente një fytyrë miqësore, të qeshur.
Edhe i mërzitur ndenji përpara tryezës, midis dëshpërimit dhe një dëshire për të qarë. Ishte në atë çast, kur zemra tepër e ngarkuar kërkon të çajë kraharorin si një zog i burgosur dhe të sulet mbi qelqet e dritares. Mori pendën, kërkoi një çlirim në të shkruar, ti rrëfejë kartës vuajtjet e tij.
II.
Më kujtohet mike , ajo ditë kur ne ishim ngjitur lart, që të shihnim malet me akull. Ishte edhe ahere vjeshtë, po frymë e diellit i jepte shpirt çdo sendi. E mban mend, me sa gëzim kishim ecur, duke mejtuar se një ecje m’e gjatë, një udhë m’e lartë po na priste atje sipër? Pastaj gjetëm ujë, ujët e qiellit, bashkuar me ujët e dheut në një sy të refkët. Orët na shkuan të ëmbla. Ishe pranë meje, qeshë afër teje dhe melankolia e kësaj cope dimri të shpejtë ishte për ne një afrim i ngrohtë.
Tani vetmia më jep një të ngjethur në shpirt dhe kërkoj një mbrojtje. Rri kujtoj kohën e shkuar, atëherë kur vështrimi yt hidhte pranverën dhe të ngrohtit e dashurisë, lumturi e shkuar që hedh dritë gjer në këtë shpellë të jetës.
Është thënë që njeriu të çmojë të mirën, kur nuk e ka më, se orët e lumtura janë të shkurtra dhe pikëllimi na duket pa mëngjes. Tani që mejttoj atë kohë kur të kisha pranë, tani e kuptoj çfarë humba.
Atëherë më dukeshe si një thesar i sigurt, që nuk do të ketë fund, një pasuri ku do të mundnja kurdoherë të mbushnja grushtet pa frikë se mos shteronte.
Nuk ta dita vleftën e vërtetë;dëshira e punës, ethet e të bërit gjësend, siguria se duhet të jem i dobishëm në një punë, dëshira e shërbimit, kush e di, mbase dhe ambicioni i ditëve, kur njeriu është i ri, më bënëin që të mos çmonja thesarin, që kisha në gjí. Më dukej se ato ditë s’do të mbaronin kurrë dhe, nganjëherë, oh, jepmë leje t’i rregulloj të gjitha, ndjenja një padurim për punë, që më kafshonte kraharorin.
S’e dinja që livadhet nuk lulëzojnë kurdoherë. Duhet të isha në këmbët e tua, në adhurim të syve të tu dhe të thëthitnja në vështrim të nxehtë të gjithë lumturinë e të dashurit dhe të qenit i dashuruar. S’e dinja që çastet e punës, që i kurseja me aq zili, janë gurë pa ndonjë vleftë, kur s’i ndrit asnjë shkëndijë dashurie.
Tani po e kuptoj. E kuptoj se ato ditë, në të cilat rrojmë në dritën e syvet qëduam, ato janë të vetmet ditë të bardha të jetës ...
III.
Nuk e mbaroi dot letrën. Deti po hidhte brenda në odë dritën e tij të gjelbër e të turbullt dhe qielli, duke u lartësuar, kish zbuluar malet, ku akoma copa resh ishin nderë nëpër yje. Dhe në të ftohtët e tanishëm psherëtinte për një dorë, që ta mbante në grushtet e tij si një zog të vogël, për një prehër, ku të mbështillej si në gji të mëmës.

KUR MBRËMJEVE KTHEHEM I LODHUR
Kur mbrëmjeve kthehem i lodhur në shtëpi, kur shtati i tërë më është dehur në lodhje e në forcime, një pikëllim i thellë më pushton shpirtin, se rreth meje nuk shoh veçse vetmi, një zbrazëti të ftohtë. Çdo gjë që më rrethon, më duket e huaj, më jep frikë.
Padyshim, s’jam edhe lodhur prej mërgimit. Në ëndërrimet e mija, në projektet e mija të pritmit, ushqenj shpresën që të shoh edhe shumë tokë e qiej të huaj, të kem akoma shumë dete dhe male për të kaluar. As këmbët as shpirti s’më janë mpirë dhe nginjur, se një dëshirë çdo ditë të re më djeg dejet.
Po ajo që dua, mike, është që çdo mbrëmje, pas çdo bredhje të marrë dhe lodhjes pa kursim, të gjej një fole të ngrohtë miqësie dhe dashurie, një vatër të vakur, ku të mund të ngroh këto duar, që më mbërdhijnë nganjëherë.

LETRA DASHURIE TË MID’HAT FRASHËRIT:
Emmës,
“Mikeshë, as vetë nuk e di në do të ta dërgoj ndonjëherë këtë letër. Por prapë po e filloj si një nevojë konfidenciale, duke dashur të hap zemrën, e po ashtu të ringjall kujtimin.
Të kisha thënë në Nenchôtel se po linja një pjesë të zemrës sime në Lozanë. Përse po ta shkruaj ty këtë gjë, mikeshë e dashur? Ngaqë isha aq i trishtuar atë ditë. Ajo quhej Elsa dhe shpesh, në çaste shpërthimi ndjenjash - veç kur e quaja me emrin tënd. Kaq shumë ky emër është i gjallë në mishin tim. Tetë vitet që na ndajnë as që e kanë fshirë këtë kujtim; të tjera vite erdhën e u mbishtresëzuan, por ai vit i themeltë mbetet përherë.
Pra, në pensionatin e vogël ku unë banonja në Lozanë, kishte ndër të tjerë persona edhe një grua, që më habiti që ditën e parë kur e pashë në tavolinë mes të tjerëve. Ishte një brune e gjatë, me floknajë të bollshme, pis të zezë që e rregullonte mbi ballë në mënyrë të tillë si t’i krijonte një mburojë mbi sytë, po ashtu shumë të zinj. Kjo floknajë, hunda e saj paksa e madhe dhe e fortë, forma e buzëve, veshja e përzgjedhur, sa elegante aq edhe me shije të hollë, i jepnin asaj një pamje interesante dhe më bënë ta kundroja si një të dashuruar marrëzisht, si një grua misterioze, me maskë paksa tragjike. Dhe e tërë pamja e saj më tërhoqën vëmendjen.
Ajo tjetra, gruaja tragjike, pra, që më interesoi, nuk dukej aspak e zemëruar me fqinjet e mia. Më thoshte madje se në u drejtoja atyre fjalën, këtë e bëja vetëm për mirësjellje, sidomos në mënyrën franceze. Vetë ajo kënaqej tepër shpesh, duke më vëzhguar së largu, duke më analizuar dhe gjatë shëtitjeve tona i pëlqente të më përshkruante nga ana morale, shpesh me një saktësi të madhe, gjë që më bënte të mendoja për ty, sepse edhe ti, Emma, më ke njohur mirë dhe shumë mirë nga afër.
Unë nga ana ime, vëreja se ajo grua ishte e një natyre të çuditshme. Shihja se kisha të bëja me një grua aspak sentimentale dhe me shumë përvojë, disi e zhgënjyer, përvoja këto që ia lejonte mosha e saj, sepse duhej të kishte pak vite më shumë nga unë, gjë që e bënte në sytë e mi edhe më grua dhe sidomos shumë të dëshirueshme. Kisha një pasion të vërtetë për këtë person dhe ndjeja një grishje tek e shihja herë-herë shumë të distancuar nga unë.
E kaloja kohën mes ca punëve të vogla dhe pasionit që ndjeja. Një ditë në tryezë, po i përshkruaja fqinjit tim në krahun e djathtë rrugën që doja të ndiqja gjatë kthimit, në mënyrë të tillë që t’i bija qark Zvicrës dhe të vizitoja qytetet e mëdha të Italisë; zyrisuaza** përballë meje më pyeti nëse po jepja kësisoj mësim gjeografie dhe kur unë i shpjegova qëllimin, më tha që më mirë se kushdo tjetër mund të pyetej e të konsultohej ajo vetë për itinerarin që lypsej të ndiqja, si një njohëse e mirë e Zvicrës që ishte. E besova dhe iu luta të më kushtonte pak kohë për të studiuar itinerarin te Bedekeri*** im.
Të nesërmen pas ngrënies shkuam në dhomën time ngjitur me sallën e ngrënies dhe për dy orë studiuam Bedekerin duke biseduar gjerë e gjatë; biseda me të më dukej e këndshme dhe vura re se e kapte në çast mendimin që shprehja.
Të pasnesërmen, si mbaruam vaktin, më pyeti në dëshiroja të vazhdoja seancën gjeografike dhe më grishi ta shoqëroja në shtëpi. Pranova me shumë dëshirë, duke qenë se më joshte së tepërmi mendimi që ajo grua po tregohej e gatshme të më këshillonte rrugën që duhej të ndiqja për të përfutur kohë dhe vendet më interesante, që ia vlente të vizitoja.
Si dhe një natë më parë, kur e shoqërova gjatë kthimit, ndoqëm të njëjtën rrugë. Banonte në kat të parë, në një apartament që e kishte të vetin. Dhoma në të cilën hymë, kishte goxha hapësirë, e rregulluar bukur, e mobiluar dhe një piano renditur përgjatë njërit mur. Vura re një këmbalkë me kanate shpalosur si të na priste të vendoseshim para saj, një tryezë të vogël dhe aty-aty, mora në duar një libër e ia nisëm bashkëbisedimit. Më tërhoqi biseda e saj që më dukej më interesante nga konsultimi që do t’i bënim Bedekerit tim.
Ishte shumë e qeshur, shumë e thjeshtë dhe shumë e zgjuar. Ndjehesha si i lumturuar që ndodhesha në prani të saj, krejt vetëm në atë apartament të madh. Pashë që kishte gjykim të shëndoshë, që më bëri të mos i kurseja fjalët, as gëzimin. Po prapë, e ruaja plotësisht vetëdijën dhe pamjen e ftohtë. Ti e njeh, Emma, atë pamjen time të ftohtë, sepse shumë shpesh më thoje që pështypja që unë lija përgjithësisht te të tjerët ishte e një njeriu tepër të ftohtë, kur ende nuk më njihnin nga afër.
Folëm, pra, për gjithçka, gjithë gjallëri. Një hop, nuk e di se si, folëm për modën, dorashkat dhe këpucët. Më tha se unë kisha duar shumë të vogla. Vura re të sajat, që ishin vërtet vogëlake e tepër të hijshme; ia pohova, por nuk shfaqi kurrfarë ndjenje; tek e vëzhgoja, më tërhoqi vëmendjen një njollëz e imët, një nishan mbi pulqerin e saj; ia mora dorën dhe e pyeta ç’e kishte atë. – Nishan, ma ktheu me thjeshtësi.
Ia çova atëherë dorën te goja dhe putha njollëzën e kuqërremtë. Pastaj, u vura në kërkim të të tjerave nishane, i zbulova edhe një syresh mbi pëllëmbë dhe sërish ia putha; më pas, u ringjita drejt krahut: kishte një njollë shumë të vogël në pjesën e brendshme të bërrylit; vura edhe aty në përdorim buzët, ia ngjesha shumë fort mbi atë lëkurë të përsosur, gjithë ngrohtësi. Nuk e kisha më atë gjakftohtësinë time.

Ajo qendronte mendueshëm, pakëz e tendosur. Ishim që të dy në të njëjtën kanape, shumë pranë njëri-tjetrit. Elsa kishte mbështetur bërrylat mbi gjunjë, duke vështruar para saj, me kryet përkulur para; ky qëndrim ia nxirrte krejt qafën, një qafë e mermertë, që i dilte nga bluza e bardhë dhe ku rendnin cullufe mëndafshi të zi aq fijeholla. Atëherë, ia mbështolla kryet me krahët e mi* dhe shtrova një puthje të gjatë, shumë të gjatë mbi atë qafë. Ajo, as që mbrohej aspak, ndonëse qëndroi ende për një çast e tendosur, si e hutuar.

I thashë se e dashuroja, që prej disa ditësh. Nuk gënjeja, sepse vërtet, disa ditë më parë, pas një bisede të këndshme në tavolinë, ajo më kishte ngulur sytë e nuk m'i shqiste. Ai vështrim më kishte hutuar, më kishte turbulluar disi. Por u hoqa sikur nuk i kushtova vëmendje. E megjithatë, shpesh mendja më shkonte aty. A të kujtohet Emma vështrimi yt, ai vështrim falë të cilit nisi dashuria jonë?

Atëherë ajo më pohoi se më dashuronte për një kohë edhe më të gjatë, madje që i kishte folur për dashurinë e saj tim fqinji të tavolinës, një zotni burrë, me të cilin unë e pandehja atë të lidhur, pa e ditur as vetë përse, gjë që ai ia bëra Elsës të ditur duke i thënë se ishte pikërisht kjo arsyeja për të cilën unë nuk i kushtoja në dukje vëmendje. Më pas, ajo më tregoi se e kishte njohur fqinjin tim në një pensionat tjetër, ku kishin qenë që të dy dhe se midis tyre nuk kishte pasur veçse tim një miqësi e rëndomtë.

Mëngjesi më gjeti zgjuar në dhomën e Elsës. Ishte aq e ëmbël, aq fëmijërore dhe prapë, aq e zgjuar dhe aq e qeshur. Mjerisht, lumturia jonë nuk do zgjaste gjatë. Ti e di, Emma, sëmundjen morale nga e cila unë vuaj, ajo mani për t'i analizuar gjërat, ajo ngasje për të gërmuar përherë në thellësi të tyre, duke dashur të shoh larg, ta konsideroj shumë shpesh të tashmen si preokupim të së ardhmes. Isha i lumtur me Elsën, por mendoja edhe të nesërmen, ndarjen. E njëjta gjë e mundonte edhe atë dhe ishte në krizë.

Mirëpo, një tjetër krizë më e madhe po më priste. Një ditë, ishte një pasdite e bukur, ajo filloi të luante në piano për mua. Para dashurisë sonë, më kishte grishur në fakt një të diel, nëpërmjet tim fqinji, kur do të luante në piano në shtëpi, për të shoqëruar një mikeshtë këngëtare të vetën. Nuk e kisha pranuar ftesën, duke nxjerrë një arsye e aq, sepse, në fakt, i kisha premtuar një shëtitje asaj tjetrës, atë që e kam quajtur tashmë në fillim të kësaj letre gruaja tragjike. Këtë radhë, pjesa muzikore që do të interpretonte më kushtohej vetëm mua. Luante në piano dhe këndonte me zë mjaft të ulët, shumë të ëmbël, të butë. Këndonte operetën “Pupphen”, më pas pjesën muzikore “Sikur të më kërkonit emrin e asaj që dashuroj, edhe një perandori të më premtoni, nuk do t’jua tregoj”, të Alfred de Musset, më pas një tjetër po ashtu, si dhe në fund pjesën muzikore gjermane “Der zigeunerkind” (“Fëmija i ciganes”) . Fëmija i thotë t’et: “- Ky vend është kaq i bukur, qëndrojmë këtu, o atë, qoftë ky, atdheu ynë! - Jo, ia kthen i ati, - e pamundur, veç cigani s’ngulet kurrë në një vend!”

T  shprehurit figurativ kontrastik d shmohet edhe n  poezin  “Kur ata patn  keq, ti u g zove”, ku poeti Buzuku ballafaqon bot n e brendshme t  m katorit p rball  atij q  jeton af r Hyjit dhe e  mon dhe e do fqinj n e tij:

Kur ata patn  keq, ti u g zove.
Kur ata patn  mort, ti nuk i an kove.

ose
e mǎ të pëlqyem pate
kur gjegje keq për ta se mirë.

Këtë mënyrë të shqiptimit Buzuku e përdor edhe në poezinë “E parë lij shpirtinë me i votë keq”, ku mëkatari, që ka shmangur rrugën e Hyjit dhe nuk i përfill urdhrat e tij, lejon që shpirti të jetojë në ligësi: “E parë lij shpirtinë me i votë keq”, pra çmon më shumë arin e thesaret se jetën hyjnore.

e mǎ do me pasunë
ār e vistār e gjǎ mǐbē këtë jetē
se jetënë e amēshuome

ose kur nuk shqetësohet për të afërmin, sidomos për të varfin që s’ka as bukë të hajë: “në mos dafsh kapshatënë ȳ gojet sote”.

Shqiptimin kontrastik të mëkatit dhe të pasojave të tij Buzuku e zbatoi edhe në poezinë “Aj tue klenë ginë por ha”, ku shprehet pangopësia e njeriut të hajë e të pijë pa masë: “aj tue klenë ginë por ha” përballë atij që nuk ka fare. Ky mëkat mortar shprehet edhe në përmasa të skajshme – vetëm për lakmi të fytit: “e për lakēmī të fytit djerie mos i viell”.

Buzuku e vështron mëkatin edhe në rrafshin e të menduarit, siç ndodh në poezinë: “Tue kujtuom, tue ȳ ambēltuom”, që përkon plotësisht me parimin biblik: edhe të menduarit keq është mëkat. Poezia është një përsiatje e thellë filozofike e teologjike, që ndriçon botën e brendshme të njeriut, përkatësisht të besimtarit: përmbushje e qejfit të vetvetes, krijimin e një bote jashtë realitetit konkret, po dhe jashtë dashurisë së Hyjit; i sheh gjërat të “ëmbëltuara”, sipas dëshirës dhe gjakimeve vetjake: “nukë desh me e bduom ȳ vetëhej”, e jo sipas hirit të Hyjit:

tue kujtuom, tue ȳ ambēltuom
ȳd ata të kujtuom ȳdē mend të tȳ;

Përkundër kësaj, njeriu ka brenda vetes së tij forcën – edhe kjo dhuratë e Hyjit – që ta largojë e ta shmangë nga vetja e tij të keqen dhe ligësinë, mëkatin “e kur ata të kujtuom” dhe t’i kthehet rrugës së drejtë të Hyjit dhe t’i shfrytëzojë të mirat e dashurisë së Tij.

✧

Se Buzuku kishte prirje për hartimin e teksteve poetike dhe se në to përdorte një gjuhë të pasur e figurative, dëshmojnë edhe përkthimet cilësore të disa teksteve, sidomos të Psalmeve dhe të Këngës së këngëve të BV.

Po sjell vetëm disa shembuj nga Kënga e këngëve (çështja e përkthimit të psalmeve në “Mesharin” meriton një vëzhgim më vete) që përligjin këtë aftësi dhe cilësi të Buzukut:

“Jam e zëshkë, ma jam bukurë formuam ” (KK 1, 5)

✧

“Mǎ shkoi dimēni, e shiu shkoȳ,
mǎ ngreu e dashura eme, e eja ” (KK 2, 11)

✧

“Hinje se kȳ vjen tue shkuo përmbī malt,
e tue këcyem përmbī sukat;
mbi këtë mënyrë nshhtë i dashuni em,
porsi kaprolli o mengu i sutësë.
Hinjë se jet mbas murit,
tue pasunë qyrë ȳ fënjeshtrashit,
tue pasunë qyrë ȳ birashit të murit.
E muo më foli i dashuni em,
tue me thashunë: Ngreu mama eme e bukura, e eja.
Hinjë se dimni shkoi, e shiȳ vote.
E hinje se luletë zunë me u dukuni përmbī dhēt,
e hera me kiem ȳ afëruo;
e zani i turtullit u ggegȳ ȳdē dhēt tanë;
fiku zū me lëshuom të tītē,
e ȳdhitē zunē me bām grestenē,
e lëshuomē erënë e endet tyne.
Ngreu, e eja, e dashura eme,
e e bukura eme, ȳite ti.
Polumbi em ȳdē palsēt të gurit,
ndē e ȳfshehunat të gjirdhevet,
dēftomē të klenētē tat,
banmē u tȳ të të ggegjem zanē tand;
përse zani uit anshhtë i amblē,
e të panētē tat anshhtë të dëshëruom .
(KK 2, 8 – 14)

✧

“Kush ē kjo qi vjen porsi drita qi zbardhetē,
e bukur porsi ana, e zgjedhunē porsi dielli,
e madhe porsi ȳshhtëria qi anshhtë trajtuam për luftē ”
(KK, 6, 1o)

✧

“Dora e djathtë e tȳ anshhtë muo përȳdenē krye tem,
e djathta e tȳ muo të më shtrëngonȳ .
(KK 8, 3)

Çfarë mund të ndryshojë lexuesi i ri?

Agim Baçi



Jorge Luis Borges, gjatë gjithë komunikimit të tij për letërsinë për shumë vite në Universitetin e Buenos Airesit, e konsideronte lexuesin si pjesë pa të cilin letërsia nuk do kishte kuptim. Ndërsa nobelisti Elias Canetti, theksonte se “të japësh dhe të marrësh është e njëjta gjë”, duke i dhënë lexuesit pedestalin e barazisë me autorin. Shkrimtarë dhe esstetë të tjerë, përfshi Umberto Eko, Italo Kalvino, Milan Kundera, Ernesto Sabato, Alain Finkielkraut, Harold Blum, Norman Holland, Volfgang Iser, Stenli Fish, e shumë emra të botës letrare, kanë sjellë në vëmendje rëndësinë e madhe të leximit në fatin e letërsisë.

Po në Shqipëri, ç’ka ndodhur me lexuesin e djeshëm dhe ç’po ndodh me lexuesin e sotëm?

Së pari, duhet të theksojmë se letërsia shqiptare për dekada nuk ka qenë vetëm peng i autorëve të ideologjizuar, por edhe i lexuesve të edukuar si të tillë. Shkollat shqiptare kanë qenë pjesë e të njëjtit mekanizëm që ndërtonte binomin artist-kritik-lexues-shikues, duke bërë që e keqja etike dhe estetike të kishte nisësin dhe pritësin. Lexuesit shqiptarë për shumë vite me rrallë duket sikur kanë jetuar si personazhe të Franz Kafkës, por pa e ditur se po përjetojnë atë që shkrimtari i famshëm kishte mundur ta sillte në romanin e tij “Kështjella” përmes personazheve të tij. Pra, pak a shumë, secili prej lexuesve gjendej në një situatë ku përcaktimet e jashtme ishin tmerrësisht shtypëse dhe dëshira e tyre për ndryshim ishte në gradën zero. Ata jetonin brenda kështjellës së ndërtuar nga sistemi dhe ishin programuar për atë që duhet të lexonin, të pëlqenin dhe të rrëfenin për të tjerët.

Për gjithkënd që e ka kaluar nën diktaturë, mund ta kujtojë lehtësisht faktin se mes shkrimtarëve dhe lexuesve ka qenë një zinxhir i madh burokratësh ideologë, të emëruar dhe kontrolluar nga majat më të larta të diktaturës, që përcaktonin kufij të shkruari dhe kufij leximesh. Përgjithësisht, po të shohësh shtypin letrar të asaj kohe, mungon plotësisht këndvështrimi për të Përhershmen dhe të Përtjetshmen dhe njeriu shihet si një produkt i revolucionit, si një njeri që duhet të shmangë pyetjet e dilemave shpirtërore dhe të ushtrojë veç kulturën e bindjes. Përgjithësisht kultura e kohës nuk synonte njohjen e njeriut, por ndërtimin e tij sipas një ideologjie që i kthente ata në ushtarë të bindur. “Njeriu i ri”, siç e quante sistemi i kohës, kishte më pas të drejtën të gjykonte vepra letrare, të shkruante dhe t’i kërkonte llogari artistëve për mungesën e jetës kolektive, për mungesë të pasqyrimin të realitetit, për mungesë të frymës revolucionare, et.j, etj.

Pasojën e një logjike të tillë leximi shoqëria shqiptare e ka vuajtur edhe pas vitit 1990. Klithjet e shumë njerëzve se “mungon kritika”, apo se “për artin nuk ka më aq shumë respekt”, ishin thjesht një zgjatim i mënyrës se si ishte përçuar kultura për 50 vite, ku lexuesit nuk kishin lidhje me vlerat letrare por me porosinë ideologjike. Dhe ata që ankoheshin më së shumti ishin ata që kishin ndërtuar jetën me këtë zeje ideologjike që shthuri çdo lloj shije leximi, e për pasojë edhe idha udhë jetës mediokre. Ndërkohë, ai lloj arti i i shkruar në diktaturë dhe ai lexues i keqedukuar vijuan të ishin prezentë në tekstet e shkollave. Po kështu, akademikët dhe mësimdhënësit, vijuan të jenë aktivë në përditshmëri, me të njëjtin ritëm shijesh shkrimi e leximi, duke mbajtur gjallë një frymë që ka vijuar të ndikojë ende në një moskuptim të letërsisë së djeshme dhe të sotme shqiptare.

Padyshim që letërsia, dhe i gjithë arti në përgjithësi, i lëvruar sidomos pas vitit 2000, ka sjellë ndryshime të rëndësishme etike dhe estetike. Emra artistësh shqiptarë tashmë gjenden në shtëpi botuese apo galeri prestigjioze botërore apo edhe në kinematografi, ndërkohë që reflketimet mbi këto vepra shpesh janë pasojë e një leximi dhe debati që ka të bëjë me vlera të përhershme, që e lidhin njeriun me të përhershmen dhe të përtjetshmen, që e lidhin me njerëzoren, duke dhënë garanci se kemi të bëjmë me vlera të përbotshme si në të shkruar, ashtu edhe në lexime.

Në këtë aspekt, lexuesi që po vjen mund të jetë vendimtar jo vetëm për një hierarki të re të leximit apo të rileximit të letërsisë shqiptare, por edhe të një imponimi mbi artin që lëvrohet. Leximi në të njëjtën kohë me bashkëmoshatarët të njëjtën letërsi, si dhe leximi i debateve të rëndësishme mbi mbi këto vepra, jep shpresë për një ridimensionim të këndvështrimit mbi letërsinë dhe të gjitha artet e tjera.

Emrat e shkrimtarëve shqiptarë që tashmë janë pjesë e lexuesit të hapur, si dhe të lexuesit që kanë përvojën e një debati pa kufizime ideologjike, kanë mundësinë të rivendosin një hierarki të pranueshme leximi, me më shumë argumente, me më shumë këndvështrime në gjykim, ku padyshim më tërheqëset mbeten ato lexime që e shohin njeriun në udhën e gjatë të njerëzores, ashtu siç kanë bërë edhe rrugëtimin veprat e artit që sot mbajnë flamurin e njohjes së madhe në çdo vend të botës.

Në këtë aspekt, është me rëndësi të pohojmë se lexuesi i deridjeshëm, me njohje vetëm ideologjike, i mbështjellë me nostalgjinë e së shkuarës, nuk mundet të jetë garanci për leximin e letërsisë. Madje, lexime të tilla, të botuara gjatë diktaturës, shpeshherë mund të vlejnjë për t’u treguar të rinjve se si nuk duhet ta shohin një libër. Ndërkohë që lexuesi i sotëm, i përfshirë në hullinë e leximeve të përbotshme, duhet mbrojtur dhe përkrahur, pasi nuk i përket vetëm vetes, por mund të jetë një negociator i rëndësishëm dhe një pararendës i një kritike të re për letërsinë. Sepse vetëm një debat i vendosur në shinat e së përhershmes do të mund ta sjellë letërsinë e së shkuarës dhe letërsinë e tashme në një hierarki të domosdoshme referimesh që nuk i përkasin vetëm “tanishmërisë” dhe “këtushmërisë”.

Shkrimtarët dhe lexuesit e vëmendshëm e kanë patur të qartë se letërsi e madhe është vetëm ajo që rilexohet. Shumica dërrmuese e shkrimtarëve që kanë shkruar në kohën e diktaturës e dinë shumë mirë që do të magazinohen nga harresa e madhe, ndërkohë që shkrimtarët e mohuar, si Kuteli, Fishta, Koliqi, Camaj, e shumë të tjerë si ata, që u dhunuan me harresë e përdhosje për 50 vite, vetëm do të vijnë duke u ndriçuar, pasi do të jenë nën mbretërinë e rëndësishme të rileximit.

Me profesreshën dhe drejtuesen e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Diana Kastrati: objektivi ynë, studimi dhe botimi e universit të Arbëreshëve të Italisë dhe të Zarës së Kroacisë

Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana

Fillojmë nga titulli “Cavaliere Della Stella d’Italia” me të cilin jeni nderuar vitet e fundit (2018) nga Ambasada e Italisë në Shqipëri. Për nga rëndësia ky është një titull me të cilin nderohen kontributdhënësit e krijimit të relacioneve në mes Italisë dhe shteteve tjera, në këtë rast Shqipërisë. A mund të flasim pak për ndjesinë që ju dha ky nderim kaq i rrallë?

Ndjesia më mbresëlënëse e kësaj ngjarjeje, e cila më ka mbetur e fotografuar në kujtesën time edhe më e gjallë se sa vetë ceremonia e dorëzimit të titullit, është momenti kur m'u tha nga ana e Drejtoreshës së Institutit Kulturor të Italisë, zj. Malgarini. Më kujtohet saktësisht vendi dhe koha: ndodheshim në një qendër kulturore këtu në Tiranë të quajtur “Tulla” për prezantimin e një libri. Aktiviteti nuk kishte filluar akoma dhe, sapo vura këmbë brenda në sallë, drejtoresha në fjalë më merr mënjane dhe më thotë pa xhiro fjalësh që “unë

(ajo d.m.th.) dhe Ambasadori italian (asokohe ishte në detyrë Shkëlqesia e Tij z. Cutillo) kemi menduar t'ia bëjmë propozimin Ministrisë së Jashtme italiane për dhënien e titullit mua Cavaliere. Ajo vijoi duke më pyetur nëse isha dakord apo jo dhe, pjesën tjetër të bisedës nuk e ndërmend dot meqë siç duket emocioni bëri të veten tek unë. Nga ai moment zuri fill procedura burokratike nga ana e Ambasadës. Ajo që dihet zyrtarisht është që në raste të tilla për shtetas të huaj, itinerari burokratik parashikon që përfaqësia diplomatike e vendit ku jeton shtetasi që do të propozohet për këtë titull, i bën kërkesë Farnesinës (MPJ-së italiane); pas shqyrtimit aty, në rast miratimi, i kalohet praktika për shqyrtim një grupi të ngushtë ekspertësh pranë Presidentit të Republikës italiane i cili shpreh mendimin pro ose kundër. Në rastin tim ishte po, për fat. Në ceremoninë që u zhvillua nja 5 muaj pas miratimit, u ndjeva e lumtur që mbaja në

dorë jo vetëm stemën por edhe certifikatën përkatëse të firmosur nga vetë Sergio Mattarella. Mund ta them pa ndrojtje që ka qenë një darkë në kuptimin e parë të fjalës: e papërsëritshme.

Jeni e njohur për përkthimet e letërsisë nga gjuha italiane në gjuhën shqipe. Në hulumtimin tonë, gjatë bisedave me përkthyesit e letërsisë shqipe në gjuhët europiane, bisedonim për metodat dhe teknikat e përkthimit që ata përdornin gjatë këtij procesi, po cilat janë metodat dhe teknikat tuaja?

Si çdo art, edhe përkthimi e artizani i saj, përkthyesi, ka mënyrat e veta krejt vetjake të nxjerrjes së produktit. Madje ka “dugajën” (dyqanin) që mbart fytyrën e artizanit, mban instrumentet krejt të vetat e me orare funksionimi tërësisht vetjake e të pangjashme me kënd tjetër. Nëse do t'i mbeteshim kësaj metafore, mund të themi që artizani përkthyes, është pronari e shëgerti i asaj “dugaje”. E thënë me fjalë më konkrete, si metodologjia, po aq edhe kohët e instrumentet e punës të çdo përkthyesi, janë tërësisht subjektive. Mendoj se mbase ajo që i përbashkon përkthyesit është vetmia në të




Mimoza Pllana

cilën realizohet procesi i përkthimit. Fjala vetmi mund të tingëllojë jo bukur, por në fakt, përbën thelbin e kësaj pune artizanale. Nëse do të flisja për metodën time, do të përdorja një tjetër fjalë “izolim”. Gjendja ideale për mua për të përkthyer, përmbledhet në këtë fjalë e në këtë gjendje: izolim nga çdo gjë e nga çdokush. Mundësisht në një mjedis që e kam të dashur. Nga praktika e kaluar, dy tri herë e kam përjetuar këtë gjendje. E para ka qenë para disa vitesh teksa ndodhesha në Romë me një bursë kërkimi tremujore pranë Universitetit Tor Vergata. Gjatë gjithë muajit të parë, me një regjim prej murgu të zgjedhur me vullnetin tim të lire, dilja krejt pak nga shtëpia me qira ku banoja e, pavarësisht tundimit me “zë sirenash” të Romës që pas xhameve gëlonte nga jeta, unë mjaftohesha ta shijoja diellin me limfë të atij qyteti, por po aq edhe shiun e nëntorit, nga dritarja e madhe që binte mbi rrugë. E nuk më vinte aspak keq! Shkoja në shtrat me përkthimin e zgjohesha me të; e ndërprisja për të shkuar tek bari poshtë shtëpisë për të “oksigjenuar” trurin me zërat e njerëzve e me zhurmën e makinës së kafesë e pas gjysmë ore isha prapë vetëm, ballë për ballë me përkthimin. Punoja me orë të tëra në orare absurde; natën zgjuar, ditën fjetur e anasjelltas, pa u trazuar nga askush. Telefon nuk mbaja. Kontakte njerëzore, jo. Isha e zhdukur, e izoluar jo në një ishull, por në mes të një rrëmuje e rrëmeti njerëzor prej thujse 5 milionësh. Rezultati që një mrekulli: përfundova një punë kolosale që nuk ia kisha dalë ta bëja për muaj me radhë në Tiranë. Rasti tjetër i këtij izolimi të lumtur (e përsëritur edhe nja dy herë të tjera), ishte në shtëpinë e prindërve në Shkodër. Natyrisht prindërit nuk jetojnë më, por gjithçka flet me praninë e tyre të buta përreth meje, duke ma kthyer nanuritjen e kohëve të arta kaluar në atë shtëpi. Era e njohur e librave nga raftet e vjetër, oborri me lule, shkallët, zhurmat e njohura të rrugicës, më ishin afër e prapë nuk më ndërhyjnë në izolimin tim, përkundrazi ma bënin edhe më frytdhënës.

Si rrallë përkthyes, keni arritur të përktheni tekste letrare nga një dialekt në tjetrin, si shembull nga dialekti sicilian në atë shkodran. A e bën më të vështirë përkthimin gjuha dialektore?

Ka ndodhur në një rast. Bëhet fjalë për një roman të shkrimtarit Andrea Camilleri. Kur e mora në dorë veprën, teksa e lexoja paraprakisht (më ndodh që ta lexoj para përkthimit, por edhe jo, duke ia lejuar vetes luksin e befasisë letrare gjatë procesit), njëri nga personazhet më asociohej, për të mos thënë më identifikohesha me shumë syresh të njohur në jetën reale në qytetin tim të lindjes, në Shkodër. Në kokën time ai personazh më fliste në dialekt, madje më saktë, në të folmen e qytetit të lindjes. Këtu më lindi idea që vetëm dialogjet e romanit, jo pjesën e zërit tregues, ta



Diana Kastrati

përshtasja në të folmen e Shkodrës. Dëshiroj të sqaroj një këndvështrim timin në lidhje me përdorimin e të folmeve apo dialekteve në përkthimin letrar. Duke patur parasysh që dialekti gegë nuk ka një gramatikë të përditësuar të saj (ekzistojnë të vjetrat), ngurroja ta përdorja meqenëse gjithsesi ai ligjërim i adoptuar nga unë në përkthimin e dialogjeve, prapë se prapë nuk do të ishte korrekt nga pikëpamja gjuhësore. Do të ishte një e folme informale, por kurrësesi struktura e përligjur gramatikore. Rijetëzimi i dialekteve e të folmeve në Shqipëri duhet bërë nëpërmjet punës serioze të gjuhëtarëve me përpilimin e gramatikave e fjalorëve përkatës, duke u mbështetur jo vetëm në leksikon e sintaksën arkaike të 60 viteve më parë, por duke marrë në konsideratë edhe evoluimin e tyre në aspektin sociolinguistik. Kjo vlen edhe për toskërishten letrare. Një gjë e tillë do të shpinte në një pasurim të jashtëzakonshëm të gjuhës artistike, sa në letërsinë artistike shqiptare, e po aq edhe në përkthimet letrare. Pa dashur të përsëris një aksiomë të njohur, por nuk mund të krahasohet efekti i fuqishëm stilistikor që krijon përdorimi me vend i të folmeve e dialekteve në një produkt letrar, në krahasim me përdorimin e gjuhës standarde. Duke iu kthyer përkthimit të atij romani të Camilleri-t, zgjedha të përdor të folmen informale. Më pyesni a sjell vështirësi për përkthyesin një gjë e tillë? Në rastin tim, kryesisht jo, por edhe po. Pse po? Sepse duhet ta pranoj që unë jam arsimuar dhe edukuar të shkruaj në standard. Gegnishtja letrare më vjen e lehtë ta shkruaj kryesisht nga leximet e autorëve klasikë gegë. Pse jo? Sepse gjithsesi, përvoja empirike e mjedisit ku jam rritur, ma bën më të lehtë përdorimin nga pikëpamja sintaksore të një strukture fjalie geqe.

A ju ka ndodhur që gjatë përkthimit të ndiheni sikur shkruani një tekst të ri, sikur rikrijoni?

Që gjatë përkthimit kemi një tekst të ri, kjo është e vërtetë. Por vetëm nga pikëpamja e kodit të ndryshëm gjuhësor ku mbartet teksti origjinal. Që mund të thuhet se kemi një rikrijim, edhe kjo është e vërtetë për sa kohë kemi të bëjmë me një art. Unë personalisht përjetoj ndjesinë e të bërit njësh me tekstin origjinal, duke ia ruajtur mbi të gjitha frymën e narracionit të autorit, e po aq të kohës në të cilën vendosen ngjarjet.

Ka dilema se teksti humb vlerat letrare gjatë procesit të përkthimit, si e vlerësoni ju, a mund të transferohen vlerat stilistike?

Për ta thënë me një shprehje tashmë të mirënjohur të Umberto Eco-s, përkthimi është “të thuash gati të njëjtën gjë” dhe, mbi të gjitha, gjithmonë sipas Eco-s, nuk ekziston teksti perfekt. Pra, merret i mirëqenë një marzh tolerance i transferimit besnik të origjinalit në gjuhën mbërritëse. Ky marzh lidhet me një seri faktorësh. Më së pari me faktorin e mirëqenë të njohurive të shkëlqyera gjuhësore e po kaq kulturore të të dy kodeve me të cilët operon (pra, të gjuhës dhe kulturës së gjuhës së nisjes e asaj të mbërritjes) të përkthyesit. Rezulton e pamjaftueshme aftësia vetëm gjuhësore e përkthyesit, nisur nga postulati i Humboldt, se përkthimi është kryesisht deshifrim vizionesh kulturore. Mandej vijnë në radhë faktorët e tjerë që ndikojnë në cilësinë e përkthimit si, inteligjenca empatike e përkthyesit, formimi solid i tij në shumë fusha si në atë letrar, psikologjik, psikolinguistik, sociolinguistik, historik të gjuhës etj. Andaj lipset që përkthyesi të kalojë rrugëtimin e gjatë të investimit në formimin e tij 360 gradësh, veçanërisht në shkencat humanistike.

Bazuar në përvojën tuaj të pasur në fushën e përkthimeve, studimeve letrare dhe gjuhësore, sa janë të interesura qendrat kulturore shqiptare për përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhët e huaja, konkretisht sa kontribuojnë institucionet publike në këtë proces?

Ka një interesim të themi në ngritje të institucioneve publike gjegjëse të kulturës në lidhje me përkthimin. Ka disa vjet që është institucionalizuar çmimi kombëtar i Përkthimit; është futur në praktikën e Ministrisë

së Kulturës mbështetja financiare e përkthyesve që merren me përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhët e tjera etj. Por, nëse më lejoni, unë do ta vija theksin tek një problem madhor sipas meje: formimin e të rinjve përkthyes që nuk duhet të kufizohet me projekte njëvjeçare apo më shumë, por me sistemin tonë shkollor dhe universitar. Shkolla jonë duhet të vendosë sistemin e individualizimit të talenteve në këtë fushë, vlerësimin e tyre në kohën e duhur sa janë në shkollë dhe, mundësisht, bërjen të mundur të një programi të veçantë me to. Kjo edhe në sistemin universitar. Vetëm kështu mund të krijojmë të ardhmen e sigurtë të kategorisë cilësore të përkthyesve. E fundit, por jo më pak e rëndësishme: krijimin e një shtëpie përkthimi në Shqipëri/Tiranë, e cila të futet në rrjetin e shtëpive simotra që funksionojnë prej kohësh në Europë. Mbështetja që do t’u jepej përkthyesve të huaj që merren me përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhët e tjera, nëpërmjet këtij mekanizmi, mendoj se do të ishte instrument efikas për përhapjen e letërsisë sonë në nivel ndërkombëtar.

Letërsia shqipe u përket letërsive të vogla, si vlerësoni çfarë mund të bëjë komuniteti letrar që letërsinë shqipe ta bëjë më të njohur për lexuesin botëror?

Më ka rastisur ta them edhe herë të tjera që togfjalëshi “letërsi/gjuhë e vogël” më ngjan shumë denigrues. Nuk ka gjuhë të mëdha apo të vogla, por ka folës të shumtë ose të paktë të një gjuhe të caktuar. Natyrisht që aspekti numerik statistikor i folësve ndikon në njohjen e letërsisë së atij vendi. Në gjykimin tim ka zgjidhje: kjo fillon me ridhënien e rëndësisë parësore të të mësuarit të gjuhës shqipe në sistemin shkollor; individualizimin e talenteve letrare që herët; suportin teknik e financiar ndaj talenteve letrare dhe të përkthyesve; krijimin e shkollë së kritikës letrare dhe të përkthimit; futjen në rrjet me strukturat e ngjashme në nivel ndërkombëtar; marrja pjesë në agjendën e aktiviteteve ndërkombëtare të këtyre fushave.

Në këtë përpjekje, përveç punës në Universitet, kontributi juaj i çmuar vjen edhe përmes qendrës kërkimore shkencore, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, diasporën shqiptare që me shekuj ruajti dhe kultivoi gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Cili është misioni i kësaj qendre?

Misioni i kësaj Qendre, e ngritur këtë vit, është studimi i mëtejshëm i gjuhës dhe kulturës arbëreshe, botimi në një korpus i trashëgimisë arbëreshe retrospektive dhe bashkëkohore, përhapja e saj në territorin shqiptar e përtej tij, sensibilizimi i popullatës me këtë trashëgimi unike nëpërmjet aktiviteteve diturake e divulgative. Kemi fatin ta kemi akoma në këmbë këtë thesar! Le ta ruajmë!

Meqë drejtoni qendrën, a mund të flasim për rezultatet që keni arritur deri tani dhe për ato që synoni në vijim?

Pavarësisht se miratimi në nivel qeveritar për hapjen e Qendrës është realizuar në shtatorin e vitit 2019, unë personalisht e kam marrë detyrën në 10 janar të këtij viti, funksionimi me rekrutimin e stafit është realizuar vetëm më 11 mars 2020. Më 12 mars filloi izolimi për shkak të pandemisë. Megjithatë, puna ka vijuar në kushtet e shtëpisë, por mund ta quajmë një vit krejtësisht anormal për të gjithë, jo më për një Qendër të sapongritur. Praktakisht, këtë fundviti ne do të nxjerrim të botuar katër libra mbi arbëreshët në fushën e gjuhësisë, etnografisë dhe antropologjisë kulturore. Përpos këtyre, do të dalë edhe revista studimore e quajtur “Continuum”, revistë njëvjeçare, si dhe do të zhvillohet (gjithmonë nëse kushtet e pandemisë do të na e lejojnë) Kuvendi I diturak mbi gjendjen aktuale të studimeve arbëreshe, i cili ishte parashikuar të mbahej në 16-17 shtatorin që sapo kaloi. U shty për arësytet e pandemisë, për datat 25-26 nëntor të këtij viti.

Për fund, a mund të flasim çfarë jeni duke punuar aktualisht në funksion të promovimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe arbëreshe në Itali dhe Kroaci; a

planifikoni të përfshini në projektet tuaja edhe pjesën tjetër të diasporës shqiptare?

Po i përgjigjem fillimisht pjesës së fundit të pyetjes tuaj. Qendra që aktualisht drejtoj ka një objektiv të qartë: studimin dhe botimin e universit të Arbëreshëve të Italisë dhe të Zarës së Kroacisë. Jemi akoma pa e mbushur vitin e parë të punës. Mendoj se na pret një punë titanësh, për të cilën lipsen vizione, energji të forta dhe bashkërendim forcash. Mbase na duhet të ecim fillimisht në këtë hulli për të kuptuar edhe se si mund të zgjerohet ky fokus në një të ardhshme. Ndërsa në lidhje me pjesën e parë të pyetjes tuaj, kemi vënë në plan afatgjatë dy projekte madhore, të cilat me urimin që të fillojmë organizimin e punës nga viti i ardhshëm, do të përbënin një kontribut real të çmuar për botën arbëreshe. Pa hyrë në detaje, mund të them se idea është ajo e hartimit të një Fjalori enciklopedik të Arbëreshëve i cili kërkon një bashkërendim të mundimshëm e të gjatë të forcave studimore të albanologëve të kësaj fushe brenda dhe jashtë territorit. I dyti lidhet me një projekt afatmesëm që konsiston në krijimin e një Shtëpie të Arbëreshëve këtu në Tiranë fillimisht. Por, le t’ia lëmë gjyqtarës më të rreptë, kohës, ecurinë e rezultatet!

Diana Kastrati është diplomuar pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti Histori Filologji, Dega Gjuhë Italiane. Ndër vite ka kryer një sërë specializimesh dhe kërkimesh të thelluara në këtë fushë pranë ateneve ndërkombëtarë, si: Università per Stranieri di Perugia, Università Roma Tre, Università Tor Vergata të Romës, Institutit të marrëdhënieve ndërkombëtare Clingendael në Hagë–Hollandë.

Ka punuar si pedagog e brendshme në Departamentin e Italianistikës pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Nga dhjetori i vitit 2002 deri në nëntor te 2003 punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RSH-së, pranë Drejtorisë së Vendeve Antare të BE-së duke mbuluar vendet e BENELUX-it. Nga maji i 2004 deri në maj të 2005 punon pranë Cooperazione Italiana (Ambasada Italiane në Tiranë) ku, e punësuar nga Ambasada Italiane, koordinon punën midis Ambasadës italiane dhe MPJ të Shqipërisë në lidhje me projektin e ngritjes së Akademisë Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, projekt i financuar nga qeveria italiane. Nga 2003 deri në 2020 punon si pedagog e brendshme në Departamentin e Italianistikës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Shtetëror i Tiranës. Titullare e lëndës së Sociolinguistikës italiane dhe e Historisë së Mesjetës italiane. Mban titullin Profesor doktor i asociuar. Nga 2016 deri në 2020 është Shefe e Departamentit të Gjuhës italiane pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Në cilësinë e Përgjegjëses së Departamentit të Gjuhës italiane, organizon një seri kuvendesh diturake, projektesh dhe takimesh kulturore e letrare, kombëtare e me prani profesoreske e studiuesish ndërkombëtare, si mbi: Luigi Pirandello-n, Umberto Eco-n, Letërsinë migratore shqiptare në Itali, takime me shkrimtarë italianë e përkthyes.

Kontributi i saj spikat në këto lëmi: në atë akademike (mësimdhënie në Universitet) për 24 vite rresht; si studiuese e letërsisë dhë e kulturës italiane me artikuj të botuar brenda dhe jashtë vendit në revista të specializuara të natyrës kulturologjike, sociolinguistike, letrare dhe traduktologjike (më shumë se 40 tituj); studime dhe pjesëmarrje në konferenca e kuvende diturake, si brenda dhe jashtë vendit (Itali, Francë,Rumani, Kosovë etj); në atë të përkthimit, me një numër të konsiderueshëm përkthimesh të autorëve të spikatur të skenës kulturore dhe letrare italiane; në atë të publicistikës me shkrime të karakterit kryesisht kultuorologjik; pjesëmarrëse dhe Kryetare në disa Juri çmimesh letrare.

Fituese e Çmimit kombëtar të Përkthimit për vitin 2016. Për merita të veçanta në fushën e përkthimeve dhe përhapjes së kulturës italiane në Shqipëri, në 2018 me dekret të Presidentit Italian Sergio Mattarella, nderohet me Titullin Cavaliere della Stella d’Italia.

Vështrim krahasues: Ankthi i vdekjes në prozat “Prilli i thyer”, të I. Kadaresë dhe në “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar” të G. G. Markesit

LETËRSIA NË ZONA TË KONTAKTIT

Petrit Palushi

Në prozat “Prilli i thyer”, të I. Kadaresë (1978) dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, të G. G. Markesit (1981), rrëfëhet për drama komplekse të personazheve mbizotërues të këtyre veprave, pikërisht pas njohjes së tyre me faktin e tillë: vdekja do t’i mbërthente në kohën sa më t’afërt. Këtë kohë të ndërmjetme, d.m.th., prej mësimi të faktit se vdekja për Gjorgun (“Prilli i thyer”) dhe Santiago Nasarin (“Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”) do avitej së shpejti, autorët e kanë dhënë si një kohë të zbrazët, të palëvizshme apo si kohë që po sosej njëkohësisht deri me fikjen e jetës së Gjorgut dhe Santiago Nasarit.

Tek “Prilli i thyer”, një kohë e tillë është fiksuar prej 17 Marsit deri me 17 Prill, 31 ditë kalendarike që shkojnë ngjitmas pa e prishur rendin, pavarësisht nga përjetimet e Gjorgut:

“Kryesorja ishte ajo që po ndodhte brenda tij. Dhe ajo që po ndodhte atje ishte e bukur dhe e frikshme njëkohësisht. Ai as vetë s’dinte ta thoshte se ç’po ndodhte atje. i dukej se zemra i kishte dalë përtej brinjëve, qe shtrirë gjërë e gjatë përreth dhe ashtu e përhapur siç qe, plagosej lehtë nga çdo gjë, gëzohej dhe hidhërohej fare lehtë, fyhej, dhembte, lumturohej, shkretohej nga një gjë e vogël ose e madhe, qoftë kjo

flutur, gjeth, dëborë e paanë, apo shi i mërzitshëm si ky i sotmi. Të gjitha binin drejt e mbi të, qiej të tërë zbrazeshin dhe ajo i mbante të gjitha, madje mund të mbante edhe më”.

Tek “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, një ditë jo e zakonshme për Santiago Nasarin, një ditë që do të kthente krejt përmbys frymën e tij, është shenjuar që në krye të veprës:

“Ditën që do ta vrisnin, Santiago Nasari u ngrit më 5.30 të mëngjesit për të prituri anijen me të cilën vinte ipeshkvi”.

1) Koha e ndërmjetme dhe koha reale

Koha e ndërmjetme dhe koha reale shkojnë krejt natyrshëm në të njëjtin kah, por koha ndërmjetme funksionalizohet brenda kohës reale: kjo kohë e mat si me pikatore fikjen e shpirtit të njeriut. Si e tillë, koha e ndërmjetme modelon një realitet të veçantë brenda jetës së njeriut, pikërisht përjetimin e ndjenjës së vdekjes; me mbërritjen e saj koha e ndërmjetme mbaron së ekzistuari. E thënë pak më ndryshe, koha reale (kalendarike) rrjedh pa ndalesa, rrjedh pa e

prishur formën e vet, por koha tjetër, koha e paracaktuar për të marrë frymë personazhet (Gjorgu dhe Santiago Nasari si katalizatorë të veprimeve), rrjedh si një kohë që do të kishte ndalesën e vet, ndalesë që ka të bëjë me sosjen e frymës së personazheve në fjalë.

Prozat janë autentike për nga kompozimi i përgjithshëm artistik dhe lënda artistike që i është nënshtruar këtij kompozimi, zonat e kontaktit ndërmjet “Prillit të thyer” të I. Kadaresë dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, e G. G. Markesit, janë zona të dukshme. Por fijet që lidhin zonat e kontaktit janë më të dukshme sidomos në përshkrimin e ankthit të vdekjes, ankthi i cili lëviz frymën e fundit të personazheve të Gjorgut dhe Santiago Nasarit.



2) Përjetimi i ankthit të vdekjes

Tek “Prilli i thyer”, ankthi është mbizotërues, një ankth që rrënon shpirtin e Gjorgut: njeriu merr pjesë në funeralin e vet, shikon dhimbjen, trishtimin apo dhe entuziazmin e të tjerëve për vdekjen e tij. Ai sheh një yll, shkurt, aty është fundi i tij, aty është caku i tij i fundit. Dhe fundin e tij apo fundin e mbramë, e pret pa alarm, pa britma, por me një qetësi mortore. Tek “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, ankthi është i shpejtë si në një garë vrapimi: vdekja



përjetohet shpejt e shpejt, ngutshëm dhe është si të thuash si një vdekje me një frymë.

Për Gjorgun, përjetimi i këtij ankthi përfshin një kohë prej 31 ditësh, ndërsa për Santiago Nasarin realizohet në një kohë prej pak orësh. Kjo do të thotë se vdekja u rri si kosë mbi krye, si njërit edhe tjetrit, por ndërsa Gjorgut për 31 ditë do t’ia bluante ditët një nga një, Santiago Nasarit, përkundrazi do t’ia mbyllte ciklin e ankthit për një kohë tepër të shpejtë. Ankthi pra është shtresuar në krejt qenien e Gjorgut, ndërsa tek Santiago Nasari as ka mbërritur të marrë formë. Tek “Prilli i thyer”, ngjarjet sillen brenda një strukture rrethore, saqë ia vlen të besosh se personazhi sillet e mbështillet brenda vdekjes së vet. Personazhi (Gjorgu) është parapa me vdekjen, është zhytur në dridhjet e saj, prandaj mbërritja e saj, është e ftohtë, e ftohtë akull. Personazhi ish ambientuar me vdekjen prej kohësh, prandaj shkrintari e ka vendosur në një situatë ku kish filluar ritet e vdekjes shumë kohë para se të mbërrinte ajo (“Me ato vija të çjerra në faqe e ballë ata dukeshin si me maska. Gjorgu mendonte se si do të dukeshin vallë pas çjerrjeve të gjëmës njerëzit e fisit të tij”). Shkrimtari ka realizuar një vdekje së brendshmi: drama e vdekjes e ka brejtur njeriun pak nga pak dhe ia ka paralizuar pothuajse krejt gjymtyrët.



Më sipër thamë që zonat e kontaktit ndërmjet “Prillit të thyer” dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar” janë në krijimin e situatave që sjellin në skenë ankthin e personazheve dhe konkretisht, të Gjorgut e Santiago Nasarit. Përjetimi i këtij ankthi, natyrisht është i ndryshëm dhe model në vetvete. Tek “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, shkrimtari ka realizuar një vdekje së jashtmi: një vdekje e atypëratyshme, kurrsesi e paraparë prej Santiago Nasarit:

“Santiago Nasari ëndërroi me zë të lartë.
- Kështu do të jetë edhe dasma ime, - tha. - Një jetë e tërë s’do të më mjaftojë për ta rrëfyer”.

Vdekja së jashtmi, ose vdekja që erdhi pa trokitur, ka të bëjë me faktin se vetë njeriu, të cilin do ta mbërthente vdekja, është ngritur për të përjetuar ditën e zakonshme të jetës në formën më të zakonshme. Prandaj ankthi i kësaj vdekjeje përtypet shumë më lehtë: njeriu është prezentuar pak kohë më parë me vdekjen që do ta merrte, dhe, megjithëse i duket si në ëndërr, mundohet ta përtypë sa më shpejt, ashtu rrëmbyeshëm dhe më ndryshe mund të quhej edhe si vdekje e rastësishme, pavarësisht nga rrethanat që sollën praninë e një vdekjeje të tillë. Në fund të fundit, shkrimtari ka krijuar një realitet që sjell aktin e vdekjes. Përjetimin e ankthit të vdekjes, shkrimtari e ka zhvendosur diku tjetër, në mjedisin përreth Santiago Nasarit, shumë orë më parë se ky i fundit të mësonte se çdo të binte mbi të (tjetër gjë është indiferentizmi i këtij mjedisi ndaj asaj ç’po ndodhte).

Te “Prilli i thyer”, vuajtja totale është e Gjorgut dhe jo e mjedisit përreth tij; mjedisi përreth duke e pasur, si të thuash, të ligjësuar një vuajtje të tillë si ajo e Gjorgut, e sheh vuajtjen e tij në mënyrën më të zakonshme, më të qetë, sikur të pranonte me fanatizëm dhe bindje të plotë zbatimin e një ligji të caktuar. Për mjedisin përreth Gjorgut, një vdekje e tillë shihet si normale dhe e zakonshme. Ia vlen të besosh se tek “Prilli i thyer”, kumti filozofik sikur vjen nga lashtësia, është ngjizur me kalimin e kohës dhe vdekja merr përmasat e një vdekjeje juridike; një vdekje nën normat dhe rregullat e caktuara dhe, në rastin në fjalë, të Kanunit.

Tek “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, megjithëse realiteti artistik vendoset në një kohë moderne, shkrimtari ka ngritur një realitet të dytë artistik, atë të mosreagimit të mjedisit për çfarë po ndodhte. Mjedisi përreth Santiago Nasarit merr rolin e soditësit, më saktë, të vëzhguesit të ftohtë të skenës dramatike.

3) Integrimi i aktit të vdekjes

Tek “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, ndodhia zhvillohet si në skenën e një teatri, ku protagonistët e tjerë përreth Santiago Nasarit janë të gjithë në rolin e spektatorit, të cilët sodisin me krejt indiferentizëm. Kjo do të thotë se vdekja është integruar më parë vëmendshëm në sytë e spektatorëve se në trupin e Santiago Nasarit.

Shkrimtari u ka rënë zileve të alarmit, por mjedisi është i shurdhët, tejet indiferent (“Vëllezërit Vikario ua kishin treguar planin e tyre më shumë se dymbëdhjetë vetëve që patën shkuar për të blerë qumësht dhe këta e kishin përhapur anembanë përpara orës gjashtë”).

Te “Prilli i thyer”, akti i vdekjes është integruar më së pari në trupin e Gjorgut: informimi që mund t’i bëhej më mbrapa mjedisit, s’është gjë tjetër, veçse një akt formal, një akt që ka të bëjë vetëm me informimin. Prandaj shkrimtari i ka kushtuar shumë pak rëndësi dhe vend momentit të vrasjes së Gjorgut: rrëfimi mbyllet duke përcjellë para syve të lexuesit vetëm dy vetë, Gjorgun dhe vrasësin e tij. Personazhi i është nënshtruar fatit të vet, e ka parapa atë dhe çdo gjë rrjedh nëpër linjë, sikur t’ish vendosur me dorë.

Në prozat “Prilli i thyer” dhe Kronikë e një vdekjeje e paralajmëruar”, realitetet artistike janë kompozuar sipas natyrës së stileve të shkrimtarëve; realitete të ndryshme në kompozime krejt e krejt të ndryshme.

(Fragment nga një punim më i gjatë)

GERTRUDA SHEKSPIRIANE OSE SKLLAVËRIA NDAJ PASIONEVE

Prof. dr.Klara Kodra

Gjenialiteti i Shekspirit qëndron në krijimin e karaktereve të gjallë që mishërojnë mijëra nuancat e së mirës dhe të së keqes.

Asnjë skematizëm s’ka në këto karaktere, ku thelbi social dhe thelbi individual shkrihen në mënyrë të harmonishme, ato kanë larminë dhe vitalitetin e jetës.

Romen Rolani, me intuitën e një krijuesi që kupton krijuesin tjetër, ka thënë “Shekspiri, kur i krijon personazhet e veta nuk stërmundohet; futet në zemrën e secilit dhe rivesh mendimin e tij, formën e tij, botën e tij të vogël; ai nuk punon kurrë nga jashtë”.

Figura e mbretëreshës Gertrudë te “Hamleti” është nga ato figura grash shekspiriane që janë bërë shkak për ta akuzuar Shekspirin nga disa kritikë si misogynin (të tilla janë Regana dhe Gonerila tek “Mbreti Lir”, mishërime të përbindshme të mosmirënjohjes, veseve dhe krimi. Mbretëreshës Ana te “Rikardi i tretë” që harron shpejt të shoqin dhe martohet me vrasësin e tij, figurat e ndryshme të grave grindavece të komedive).

Po Shekspiri do të nxirrte në dritë edhe figura grash të mrekullueshme fizikisht dhe shpirtërisht si Dezdemonë, Ofelia dhe Kordelia ose Zhulieta.

Gertruda për të cilën i biri do të thoshte thënien aforistike që ndonjë kritik ia atribuon padrejtësisht Shekspirit, “Dobësi, ke emrin grua!” është thjesht mishërimi i një kategorie të caktuar grash skllave të pasioneve, për hir të të cilave e injorojnë kodin moral. Ajo nuk ka ligësi në vetvete si Gonerila apo Regana, po thjesht dobësi vullneti dhe vetëkontrolli, nuk i mungojnë shkëndijat e mirësisë (dashuria amtare e sinqertë për Hamletin të cilin do ta donte ta shihte të lumtur, simpatia dhe mëshira për Ofelinë, dhimbja e çiltër për fundin e saj).

Nga ana tjetër, Gertruda, duke qenë mbretëreshë e quan veten më të lartë se kodi moral i njerëzve të thjeshtë, madje edhe më të lartë se i biri, madhështinë morale të të cilit nuk e kupton deri në fund, gjersa arrin t’i thotë në një dialog me të “Harron përpara kujt po ndodhesh?”, nuk pendohet për gabimin e saj tragjik për të cilin nuk është e vetëdijshme, martesën me vrasësin e të shoqit. Sipas të gjitha gjasave, ajo s’është bashkëfajto e burrit të dytë në krim, madje tmerrohet kur dëgjon akuzën e Hamletit “Të vrasësh një mbret!”, po s’ka aq kthjelltësi logjike sa të kuptojë thelbin imoral të burrit që dashuron dhe krimet e tij. Duket edhe (Shekspiri e lë të paqartë këtë pikë) se ajo nuk ka arritur në shkelje kurore dhe incest sa ishte gjallë burri i parë, ndonëse dashuria e saj për burrin e dytë mund ta ketë pasur pikënisjen që në atë kohë. Ajo është aq larg ndërgjegjësimit për fajin e vet dhe për fajet shumë më të rënda të të shoqit sa guxon t’i thotë të birit “E ke lënduar fort tēt atë, Hamlet”, duke e quajtur të shoqin, njerkun dhe xhaxhanë e Hamletit si baba të dytë të tij.

Qëndrimi i saj në këtë çast nuk është, as hipokrizi, as paturpësi, është një lloj verbërie morale.

Ajo është larg së qeni një përbindësh vesi si përfytyrohet në një çast të caktuar nga i biri që i zhgënjyer në dashurinë më të shenjtë të birit për nënën e cila përfytyrohet në përgjithësi nga të gjithë bijtë si një ideal i lartë moral, pothuajse si shenjtore, bie në ekstremin tjetër, duke e quajtur si mishërim të ligësisë.

Për këtë gabim të Hamletit flet edhe Bielinski.

E përsërisim, Gertruda është thjesht një qenie e dobët, jo e aftë për ligësi të ndërgjegjshme dhe aq më pak për krim, po gjithashtu po aq e paaftë për t’iu

bindur, qoftë normave të larta morale, qoftë për të përjetuar një katarsis.

Ajo trembet nga ajo rreze drite që hedhin në ndërgjegjen e saj fjalët e të birit, ndërgjegjësohet se ka gabuar, po nuk është e aftë të dalë nga ato rërëra të lëvizshme që e kanë larguar nga e mira. Kjo duket në fjalët e saj plot frikë dhe dyshim “Më thuaj si të bën?” Ajo kërkon një ndihmë morale të pamundur nga i biri, meqenëse, edhe në qoftë se ai do t’ia shtrinte dorën për ta nxjerrë nga pellgu i vesit, ajo vetë s’do të mund ta kapte atë dorë: ajo e do verbërisht partnerin e vet, të cilin e ka parë thjesht si më të ri dhe tërheqës se burri i saj i parë, gjë që ka zgjuar tek ajo një pasion thjesht fizik; ndonëse tani ajo fillon të shohë me tmerr veset dhe krimin e mundshëm të tij, për inerci vazhdon ta dojë, jo me atë dashuri të lidhur me solidaritetin në krim të Ledi Makbethit për të shoqin (Ledi Makbeth është një grua shumë më e fortë dhe e mençur se ajo që shtyhet në krim nga ambicia), po me një pasion të verbër që ngrihet mbi çdo moral.

Megjithatë, në fundin e tragjedisë, Gertruda kur bie vetë viktimë e kurthit të ngritur për të birin dhe vdes, e vlarë pa dashur nga vetë i shoqi, gjen aq forca në vetvete për ta denoncuar krimin “... vera, vera! Hamlet, bir! / E pira, vera! Më helmuan!”

A ka një shkëndijë katarsisi në këtë klithmë të fundit? Vështirë ta thuash. Kur zbulon krimin e fundit të të shoqit që godet të birin, asaj i rizgjohet dashuria amtare dhe synon ta paralajmërojë djalin për rrezikun; mbase, si nënë, ndjen një farë gëzimi se po vdes në vend të tij (Ajo s’e di se në atë çast për Hamletin s’ka më shpëtim, meqenëse edhe maja e rapjerës ishte e helmuar, ndofta ka iluzionin se i ka shpëtuar jetën).

Gertruda është mishërimi i atyre grave dhe, më gjerë, i gjithë njerëzve të dobët që i çon në gabime të rënda, madje në disa raste, edhe në krime, “zemra e pabesë”, siç përkufizohet në mënyrë të goditur dhe sintetike në Bibël.



KUR VJEN DASHURIA

Feride Pappleka

«Jam i humbur, e kupton, i përmbytur nga dashuria;
nuk e di nëse jetoj, nëse ha, nëse marr frymë, nëse flas. Por e di që të dua».

Alfred de Musset



Duke filluar nga poema *Iliada* e Homerit, poezia ia ka lënë vendin kryesor dashurisë. Në teatër gjithashtu fatet njerëzore përmbledhen shpesh në fjalën dashuri. Edhe në prozë ligjërimi kryesor i kushtohet dashurisë. Dashuria është një ndjenjë universale dhe një temë e përgjithshme për krijuesit e të gjitha fushave. Ajo i ka bërë të famshme sidomos disa vepra letrare duke filluar nga Dante, Petrarka, Ronsard, Goethe, Rousseau, Stendal e të tjerë. Studime të shumta kanë hedhur dritë mbi këtë dialog tejkohor nëpër tekste dhe në krijime të tjera nga njëra anë dhe konceptit shoqëror për dashurinë nga ana tjetër. Ato kanë pasur si qëllim të shohin sesi janë pasqyruar prirjet e dashurisë përmes epokave qysh në Antikitetin greko-romak e duke vazhduar me dashurinë në kohët e reja.

Në Antikitet dashuria ka qenë objekt pyetjesh dhe diskutimesh të gjalla e të shumta. Prandaj edhe grekët dallonin katër lloje dashurish dhe mes të cilave i kushtonin rëndësi sidomos dashurisë hyjnore (*agape*), e çinteresuar nga materialiteti, e pakushtëzuar nga rrethanat. Edhe në shqip folja «dua» ka kuptime të ndryshme, ashtu si në disa gjuhë neolatine. Me forma të ndryshme kuptimi, dashuria ka luajtur dhe luan një rol madhor në marrëdhëniet shoqërore, duke zënë një vend themelor në psikologjinë njerëzore dhe duke u shndërruar në një nga subjektet më të shpeshta të imagjinatës njerëzore që nga hyjnitë mitologjike e deri te realiteti i ditëve tona. Si në Lindje ashtu edhe në Perëndim kemi pasqyrime të ndryshme me fjalë, por edhe me figura të dashurisë. Tema e dashurisë mbetet tema qendrore e shumë veprave letrare e filozofike, por edhe e pikturës, e filmave, e këngëve, e fjalëve të urta, sipas kulturave dhe epokave të ndryshme.

*

Le të ndalemi pak në letërsinë franceze: që nga *Tristan et Iseut*, një legjendë mesjetare e keltëve për dashurinë, anonime, për të cilën Richard Wagner-i kompozoi një opera, që është quajtur dramë muzikore, një krijim i frymëzuar edhe nga dashuria e tij për poeten Mathilde Wesendonck ; *De l'amour* (Stendhal), *Belle du Seigneur* (Albert Kohen), *Les Crimes de l'amour* (Sade), *Derniers poèmes d'amour* (Paul Eluard) e pastaj në vepra të tjera poezi dhe prozë kushtuar dashurisë me autorë si Lawrence, Neruda, Marquez, Fuentes, Octavio Paz dhe tragjedia tip, himn për dashurinë Romeo dhe Zhuljeta e Shekspirit, etj. Prusti thoshte se dashuria është hapësira dhe koha që bëhen të ndjeshme në zemër.

Kultura orientale e ka pasuruar shumë trajtimin e kësaj teme universale me disa kryevepra. Ekzistojnë mes të tjerëve disa ghazale për dashurinë, të shkruara nga poetë të shquar persianë, që janë si «poësie courtoise» franceze, por dy vargëshe, *Kitab-al Aghani* ose libri i këngëve të dashurisë së Ispahanit, *Triologie* e shkrimtarit të shquar egjiptian Nagib Mahfuz etj.

Shumë mendimtarë të filozofisë si në Lindje ashtu edhe në Perëndim e kanë kthyer dashurinë në subjektin kryesor të refleksioneve të tyre si *Le Banquet* dhe *Phèdre* (Platon), *Les Illuminations de La Meque* (Ibn Arabi), apo edhe autorë me fragmente të veprave si: Friedrich Nietzsche, Roland Barthes, Jean-Luc Nancy e të tjerë. Edhe autorë shqiptarë si Kadare me figurën e

Zanës (*Dimri i vetmisë së madhe*), apo Qosja me figurën e Rinës (*Vdekja më vjen prej syve të tillë*) e të tjerë. Më i riu, Rigel Rizaj i kushton dashurisë librin *Ameba* në të cilin dashuria jepet si dhimbje sublime.

Historitë e mëdha të dashurisë si Ulisi dhe Penelopa, Tristani dhe Izolda, Lajla dhe Mexhnuni, Romeo dhe Zhuljeta e të tjera janë ekranizuar, janë kënduar ose janë trajtuar në pikturë dhe skulpturë...

Dashuria në disa manuale trajtohet si formë shoqërore dhe kulturore, e cila ndihmon edhe për të dhënë një përkufizim sa më afër realitetit të saj. Ato analizojnë formën ideale të dashurisë dhe pluralitetin e shfaqjes së saj.

*

Dashuria në fazën e saj të lindjes mund të dallohet nga disa shenja karakteristike. Së pari është përqendrimi i vëmendjes. Kur tjetri është pranë teje, asgjë rreth e qark nuk ka rëndësi. «Ata ishin për njëri-tjetrin gjithë bota», shkruan Friedrich von Schlegel, në romanin e tij Lucinde (1799). Ky kujdes i veçantë shoqërohet me një ndjenjë afrimi të madh («do të doja të shkrihesha, të bëhesha një me atë»), thonë shumë personazhe në veprat letrare me temën e dashurisë. Dashuria të mëson të gjesh një sjellje të veçantë e të ndërtosh lidhje dashurore të mahnitshme, nëse kjo dashuri është e dyanshme. Një histori dashurie kur nis ka një lloj magjie dhe mahnitjeje. Do të donim të besonim se ajo është gjithnjë unike dhe universale. Por duke e vështtruar së afërmi në jetë, dashuria zhvillohet sipas disa ligjeve të pashkruara, që kanë udhëtuar nëpër kohëra.

Në dashuri ai ose ajo presin orën e takimit. Ndihen të lumtur. U këndon shpirti. Mendojnë gjithçka që lidhet me njeriun që dashurojnë: siluetën, duart, fytyrën, buzëqeshjen. Shpeshherë ata e kanë shpirtin të robëruar nga një ndjenjë e papërcaktuar. Janë të emocionuar, të verbuar, të tronditur. Çfarë gëzimi të vështroresh në sy, ndërsa drita të duket më e shkëlqyer nga pasioni i dashurisë. Dhe çfarë vuajtjeje nga tërë ajo dashuri dhe bukuri e humbur. Edhe nëse mungon ai ose ajo, dashuria është gjithnjë e pranishme në formën e një mendimi që të shoqëron kudo. «Dashuria bën të ëndërrosh, të jetosh e të besosh», thotë Hygoi. Kjo është karakteristika e dytë kur ke rënë në dashuri. Një shenjë tjetër është gjendja e frymëzuar. Ata që bien në dashuri janë të lumtur, plot energji, të gatshëm për vepra heroike. Fjalët e pasionit dashuror e tregojnë mirë gjithë këtë transformim të qenies. Idealizimi është një tjetër tipar që shfaqet kur je i dashuruar. Qenia që dashuron është e stolisur me të gjitha cilësitë e zgjedhura, kurse të metat nuk ekzistojnë. Prandaj thuhet që dashuria të verbon. Megjithatë, gjatë kësaj faze të rrëmbyer, nuk është e ndritshme çdo gjë. Kur nuk është e pranishme qenia e dashur, dashuria ka edhe shenja mangësie. Kundërshtimi më i vogël mund të çojë në rënie në depresion. Ai që dashuron është i shqetësuar, xheloz, në kërkim të përhershëm të treguesve të dashurisë të tjetrit.

*

Helen Fisher, sociologe amerikane, në librin *Përse duam* (2006), na mëson të dallojmë tre lloje

dashurie: ajo që karakterizohet nga dhembshuria, ajo që karakterizohet nga dëshira erotike dhe dashuria e vërtetë. Fisher e mbështet analizën e saj mbi dy studime kushtuar dashurisë. I pari del nga një anketë e madhe ndërkulturore Amerikë-Japoni. Pavarësisht nga moshja dhe besimi, më tepër se 75 për qind e njerëzve të pyetur deklarojnë se «të dinë se i dashuri apo e dashura është i dashuruar me të, ka më shumë vlerë sesa marrëdhëniet fizike». Kjo deklaratë nuk është thjesht iluzion. Për ta vërtetuar këtë një ekip kërkuesish ka bërë studime për veprimet e trurit në rastin e dashurisë e të dëshirës erotike. Shumë të rinjë e të rejave iu kërkua të vinin me fotot e partnerëve e t'i shihnin gjatë kohës që truri i tyre kalonte në skaner. Përfundimet e imazherisë së trurit vërtetuan se dashuria dhe seksi shkojnë në zona të ndryshme të veprimtarisë trunore.

Edgar Morin, filozof francez, mendon se dashuria nuk mund të reduktohet në seks, as në një ndjenjë të përkryer. Ai e sheh atë si një tërësi emocionale, thënë ndryshe si një alkimi shtysash të lidhura fort. E ngjashme me një eliksir dashuria formon një përzierje të re.

*

Miti i dashurisë pasion e fton secilin të ndërtojë një histori nën formën e një kohe unike të çuditshme e të paharruar, duke shmangur jo rrallë kontekstin, masat paraprake apo kërkimet që mund t'i japin kësaj historie tjetër kuptim. Të dashuruarit pëlqejnë ta përqendrojnë takimin e tyre në një moment origjinal, shumë të idealizuar.

Sociologu italian Francisco Alberoni, thotë se, dashuria me shikim të parë ekziston në të gjitha kohët e në të gjitha vendet. Ajo shkakton kudo të njëjtat kundërveprime, të krahasueshme me ato të një zbulimi. Studime të shumta sociologjike tregojnë se ka megjithatë një rindërtim në rrëfimin kanonik me rregulla normative. Atij modeli i kundërvihen rrëfime të mëvonshme. Një shoqëri që shndërrohet në miqësi, shkon drejt jetës në çift, përpara se dashuria të vendoset përfundimisht mes dy personave. Për sa i përket formimit të çifteve, gjërat kanë ndryshuar shumë këto tridhjetë vjet, qoftë në jetën reale, qoftë në Internet. Sociologët flasin për një revolucion të vërtetë «kopernikian» në marrëdhëniet dashurore qoftë heteroseksuale, qoftë homoseksuale.

A jemi të barabartë përpara dashurisë?

«Sepse ishte ai, sepse ishte ajo». Pasioni dashuror paraqitet si një takim magjik dhe i mrekullueshëm midis dy qenieve njerëzore. Një magji e pashpjegueshme që përgjithësisht nuk i njeh ligjet e psikologjisë dhe sociologjisë. Por realiteti ka treguar dhe tregon se ka madje «ligje të tërheqjes» që nxisin joshjen. Për të qenë i dashuruar duhen tri gjëra: rinia, bukuria, zgjuarsia. Kjo del nga anketat, cilido qoftë vendi, feja, seksi. Afria në moshë është po ashtu kriter i rëndësishëm, lidhjet me diferencë të madhe moshe bëjnë pjesë në përjashtime. Ngjasimi i dy të dashuruarve luan rol për vlerat, mënyrën e jetesës, shkallën e arsimimit dhe rrethin shoqëror. Ekziston edhe një barazimtarë shoqërore: të dashuruarit i përkasin përgjithësisht të

njëtit univers shoqëror dhe kulturor. Këto përcaktime të fshehta kanë rëndësinë e tyre.

A vazhdon gjithnjë dashuria ?

Kjo është një temë e ndërlikuar që në ditët e sotme ka edhe përgjigje të pakëndshme, por një mit i lashtë tregon se dy të dashuruar qenë plakur bashkë dhe e vetmja dëshirë e tyre ishte që jo vetëm të jetonin ende, por edhe të vdisnin të dy në një çast. Atëherë Jupiteri i transformoi në dy pemë të mbjella pranë e pranë në përjetësi.

A është vetëm një mit dashuria e përjetshme? Në jetë njihen çifte të bashkuara, thellësisht të shkrira, mbi të cilët duket se koha nuk ka vepruar. Pas shumë vjetësh jete së bashku, ata i kanë vështrimet ende plot dashuri. Por kjo gjë nuk është e shpeshtë. Duhet pranuar se dashuria është e brishtë.

A mund të mësohet arti për të dashuruar?

Libri *Arti për të dashuruar* i Ovidit, poet romak, i shekullit I është një traktat për joshjen, në të cilin autori u jep këshilla të vlefshme të rinjve për mënyrën si të sillen me vajzat. Por nuk duhet harruar se jemi në Romën e lashtë, në një shoqëri tepër patriarkale. Në shekullin XX përsëri shkruhet një libër me të njëjtin titull *Arti për të dashuruar* (1956) nga Erich Fromm (1900-1980), një filozof marksist i shkollës së Frankfurtit, ihtar i teorisë së Frojdit, i cili nuk e përmend fare Ovidin. « Hapi i parë është që të jemi të vetëdijshëm se dashuria është art », shkruan ndër të tjera ai. Ky vizion është diçka e veçantë. Dashuria e vërtetë nënkupton të kapërcesh narsicizmin ose varësinë me qëllim që të vendosësh një lidhje dashurore që mbështetet edhe mbi respektin ndaj tjetrit. Për Ovidin arti për të dashuruar qëndron te joshja, te Frommi ky art është një leksion moral për respektin ndaj tjetrit. Të dy autorët sidoqoftë i bashkon ideja se dashuria nuk është një ndjenjë e pandryshueshme, ajo duhet “ mirëmbajtur ” e duhet zhvilluar.

*

Për dashurinë janë propozuar shumë tipologji si në librin *Les Couleurs de l'amour* (Alain Lee, 2007), në të cilin analizohen termat grekë eros dhe agape. Disa teori të tjera tipologjike si ajo e trekëndëshit apo dashuria « triëndore » përshkruhen gjatë nga psikologu amerikan Robert Sternberg. Ai e jep dashurinë si një ndërtesë me tre shtylla që janë: pasioni, intimiteti dhe angazhimi. Brenda këtij trekëndëshi shfaqen disa tipologji dhe qëllime dashurore që nga « dhembshuria » deri te « dashuria e përmbushur ». Ndërsa psikanalistët, duke u mbështetur te një zgjedhje e veprave letrare që shkon nga Proust-i deri te Simenon-i, kuptohet duke kaluar nga Tolstoi, e vështrojnë dashurinë të lidhur me pritjen. Disa mendojnë se dashuria vjen si rezultat i zgjedhjes. Disa të tjerë thonë se saktësisht, dashuria nuk është zgjedhje: ne nuk zgjedhim as ndjenjën për të dashuruar, as njeriun që do të dashurojmë. Ka edhe nga ata që thonë se në të vërtetë dashuria është një lloj « verbimi » ose një « marrëzi ».

Shpesh dashuria shenjon forma që e përjashtojnë seksualitetin, si bie fjala dashuria platonike, që vjen nga emri i filozofit grek Platon. Nuk është fjala për ndonjë teori të formuluar nga Platoni, por për ide të shtruara te dialogët *Banketi*, *Republika*, *Fedri*, në të cilët flitet për një dashuri ideale, për marrëdhënie edhe në largësi që vlerësojnë më tepër cilësitë e personit se sa personin vetë. Një nga të ftuarit e librit të famshëm *Banketi* e përshkruan dashurinë si një gjë të kulluar e fisnike, pothuajse qiellore që ka si objekt shpirtin dhe jo trupin. Gjatë Rilindjes dashuria platonike u shndërrua në një konceptim filozofik kur dijetari i madh florentin përdori shprehjen amor platonicus, duke iu referuar dialogut *Banketi* të Platonit dhe pikërisht, fragmentit kur Sokrati përshkruan ngjitjen e njeriut nga dëshira e thjeshtë për një njeri deri në soditjen sublime.

Kam me fjetë mbi andrrën tane

poezi nga

BRIKENË CERAJA-BEKA

MË FAL PAK DASHURI

Më fal pak dashuri
Në heshtje
Kur koha ndalet
Të pres për pak dashuri
Edhe pse heshtja ka vdekë
Trupi yt ma nuk fal
As zjarr në dashuri
Do të vij një ditë
Me Karontin në Akeront
Të të zgjoj nga shtrati
Të ta marr atë dashuri
Që ta fala në gur.

TË SHENJTAT E KOHËS

Dielli i mëngjesit shndrit në flokët tuaja
e pas një shekulli heshtja lëshoi kambanën
është kohë e dritës
sa vite ikën dhe ju u gozhduat me hijen
të cilën toka jua fali
Ju të heshturat e historisë kapërditë çdo fije kohe
dhe i falet prapë dashuri dritës
e dielli me fund i lëshoi rrezet
mbi akullin që mbanit nën trupin tuaj
u bëtë një lumë i pashterur
ju të shenjtat e kohës
nuk deshët të vdisnit përveçse si në të bukurën e
ëndrrave!

SONTE

Ajo heshtur
Kalonte rrugën e fundit
Duke psherëtirë për kohën e shkuar
Një çift shfrynte epshin në mes të rrugës
Kitaristi këpuste telat me tingujt e vjetër
Lypsari kërkonte lëmoshë
Nga lypsari
Fëmija kërkonte buzëqeshjen e humbur
Engjëjt e djajtë
Loznin lojën e tyre
Në udhëkryqin e fundit
Të kryeqytetit të humbur.

PRITJA E NËNËLOKES

Rrugëve të heshtura
Ecën Nënëlokja e kohës
Ka më se një orë
Që ndjek zërat që i dëgjon
Ka më se një javë
Bisedon me ta në heshtje
Ka një dekadë që ecën
Rrugëve të heshtura
Në pritjen e lindjes së re
Eh!
Edhe pas një shekulli
Do ta presë kthimin e diellit
Do t'i presë eshtrat
O njerëz!
Ktheni kokën mbrapa
Shikoni Nënëloken
Rrugëve të heshtura
Ec e pret
Pret e ec
Pret kohën e pakohë
Pret lindjen e diellit
Pret e pret...

BOHEM

Fundosesha nën thellësinë tënde
Nga dallgët e ndjenjave
Përplasesha nga një kockë te një brinjë
Dehur lundroja mbi trupin e lagur
Si Karonti n'Akeront
Me puthje deheshim
Sonte ndihemi bohemë

NËN HIJEN E LLAMBËS

Kam me fjetë mbi andrrën tane
e me gjumin e thellë kam me aktrua si Helenë
ne lumin e vdekur kemi me diellzu
ta kujtojmë kohën kur s'i falnim puthjet
s'kam me të lanë me ra në andrrën pa diell
atje në fund të tokës kam me të gjetë
nën hijen e llambës kam me u fshehë
dritën kam me ta dhanë përjetë.



Të mërkurën, datë 17 shkurt, mbushen 15 vjet nga vdekja e poetit

DIMRI I DHIMBJES SË FREDERIK RRESHPJES

Enver Kushi

Këto ditë në arkivin tim modest, në një dosje, gjeta krahaz gazetës „Drita”, të datës 25 shkurt dhe 5 mars të vitit 2006, edhe disa fletë, ku kisha hedhur shënime të ndryshme nga takimet me Frederik Rreshpjen. Disa nga këto shënime i kam mbajtur në një bllok të rregullt dhe i kam publikuar në shkrimin „Poeti që kyçi shirat”. Gazeta „Drita”, 25 shkurt 2006, i kushtohet tërësisht njerit prej poetëve më të mëdhenj të letrave shqipe, lirikut të papërsëritshëm, Frederik Rreshpja, që ndërroi jetë më 17 shkurt të po atij viti, ndërsa ajo pas një jave botonte në faqen e dytë, shkrimin tim „Përtej thirrjes njerëzore”. Në këtë shkrim në mes të tjerash shkruaja: „Sa ishte gjallë, jeta e tij kaloi mes vorbullave dhe acareve të pashembullta. Ata që kërkuan t'i mbyllnin gojën dhe e burgosën, historia i ka zhvelftësuar. Ky poet i rrallë, i denjë për të qëndruar në krah të të mëdhenjve të letrave shqipe dhe asaj botërore, shkoi në mjerim dhe braktisje ekstreme. Sa ishte gjallë, ai i sfidoi të gjithë, duke na dhënë me poezinë e tij, por edhe me prozën e përrallat, shumë dritë, shumë dashuri, shumë ëmbëlsi, shumë gjelbërim jete, ylbere trishtimi e gëzimi, dhimbje njerëzore. Sa ishte gjallë, ai nuk kërkoi mëshirë. Frederik Rreshpja shkoi duke mos lënë, si në baladën e moçme shkodrane, një sy apo një krah jashtë. Rreshpja është i tëri mes nesh, më i gjallë se kurrë. Ai troket në ndërgjegjen e secilit, në ndërgjegjen e turbulluar shqiptare. Ai ecën rrugëve të Tiranës „me një trëndafil shiu në dorë”.

Dhe tani le t'u rikthehem shënimeve të sipërpërmendura, që janë hedhur rrëmuqshëm në vite të ndryshme, menjëherë pas takimeve me Fredin në Tiranë, apo Shkodër, ku kam shkruar me Moikom Zeqon, një nga miqtë e pandarë të poetit. Para se të shpalos disa prej tyre, u gëzoja kur gjeta edhe një shënim të shkruar nga dora e poetit:

„I dashur Enver Kushi,

Të lutem njoftojë në një mënyrë Ministrin, që t'i bëjni të fala prej meje dhe të japë një intervistë për Gazetën e Mbrëmjes, mundësisht edhe një fotografi. Eja ndonjëherë për kafe. Shumë të fala, Fredi”.

Nga e majta në të djathtë: ENVER KUSHI, ALI PODRIMJA, FREDERIK RRESHPJA, MOIKOM ZEZO



Duket, se ai ka ardhur për të më takuar në Ministrinë e Kulturës dhe kur nuk më ka gjetur atje, ka lënë te recepsioni, letrën e sipërpërmendur, që unë, pasi më ka rënë në dorë i kam bashkangjitur, këtë shënim timin:


„Takim me z. Edi Rama, kërkuar nga Frederik Rreshpja, për një intervistë të shkurtër për „Gazetën e Mbrëmjes”, që del këto ditë”. Poshtë kam shënuar edhe këtë nr. tel. 25422, ndoshta i Fredit. Nuk e mbaj mend nëse Ministri i atëhershëm i Kulturës, z. Edi Rama, u takua me Frederik Rreshpjen, për intervistën e kërkuar prej tij. Duhet parë koleksioni i kësaj gazete, në Bibliotekën Kombëtare. Dalja e kësaj gazete në mbrëmje, është ngjarje në historinë e shtypit shqiptar dhe meritë e kryeredaktorit të saj, Frederik Rreshpja. Ndoshta ka qënë vjeshtë e vitit 1998, kur ka dalë numri i parë i kësaj gazete.

Shënimet, që po i publikoj për herë të parë, herë kanë datë të saktë apo vit dhe herë-herë vetëm vitin.

SHËNIM I MBAJTUR NË SHKODËR

Shkodra të trishton në vetminë e saj. Braktisjen. Varfërinë. Jemi nisur me Moikomin herët në mëngjes, për qytetin e Shkodrës. Dita është gri dhe ftohtë, që ja shton trishtimin Shkodrës. Ndërsa shoh rrugët me gropa, suvatë e rëna të pallateve, nuk e di përse më vjen ndërmend një letër e shkurtër, që më ka dhënë miku im Sokol Kongoli e që mban datën 3 shkurt 2000: „Që prej dy ditësh na shoqëron një kohë e zymtë dhe pa qiell... Një shi i imët dhe i vazhdueshëm na shoqëron që nga momenti i mbërritjes sonë. Shkodra, duket krejt e drobitur, sidoqë nga stili i ndërtesave të vjetra dhe interesante, mbart në vetvete një botë të tërë, e cila të nxit ëndrra...”

Shkodra e drobitur, Shkodra e poetëve të mëdhenj, prej kohësh ka të drobitur një prej lirikëve më të mëdhenj të saj, Frederik Rreshpjen. Ai dergjet në një dhomë të errët. Nuk ka drita. Pashka (motra e poetit) edhe ajo e sëmurë, përqafon Moikomin dhe pastaj mua. Gjovalini



(i vëllai i Fredit) përpigjet të ndezë gjeneratorin. Kalojmë mes mobiljeve të vjetra, vendosur rrëmuqshëm në një dhomë të madhe, ku në një kënd të saj është i shtrirë Fredi mbuluar me batanije. Moikomi e përqafon, por poeti nuk flet. Vështrimin e ka të përhumbur. Duket shumë i dobësuar, me një fytyrë të parruar e të verdhë, duket si eremit. Moikomi ulet pranë tij, i vë dorën në ballë, i flet, por ai vetëm na vështron me sytë e përhumbur. Pastaj Moikomi ndez cigaren. E pi me nxitim, gat - gati, sikur e gëlltit duhanin e hidhur. Ndez edhe një tjetër... Mjeshtri i fjalës shqipe, ndoshta Deradiani i fundit i lirikës së dhimbjes shqipe, hesht me dhimbjen e tij, rrethuar nga këto mobilje të vjetra, në një dhomë pa drita e të ftohtë.

TIRANË. AZIL.VITI 2001

Prapë me Moikomin në një nga kodrat më të bukura të Tiranës, diku mbi Tregun Elektrik. Azili privat është vendosur në një vilë tre katëshe, rrethuar me kangjella hekuri, ku sapo hyn brenda, befasohesh nga oborri me pemë dhe lule të shumta dhe tavolinat e bukura vendosur nën to. Këtu ka shumë diell, dritë, ajër të pastër dhe poezi. Fredi duket mirë dhe me humor. Na çon në dhomën e tij të mobiluar bukur, ku në një komodinë ka disa fletore dhe letra, të vendosur çrregullt. Është meritë prapë e Moikomit dhe ndërhyrja e tij, që poeti të srehohet në këtë vend kaq të bukur dhe të qetë.

PA DITË DHE MUAJ. STINË E NXEHTË E VITIT 2001

Ai është nën kujdesin e Prof. Pandeli Çinës. U desh ndërhyrja e menjëhershme e profesorit dhe këmbëngulja e Moikomit, që Fredi të shtrohet menjëherë në Pavijonin e Kardiologjisë. Dhoma ku është shtruar është e vogël dhe e gjejmë të mbledhur kruspull mbi krevat. Duket i zbehtë dhe i pafuqishëm. E megjithatë kërkon që të dalim jashtë. Zbresim ngadalë shkallët dhe ulemi në një tavolinë prej hekuri, të një lokali të shëmtuar, që ndodhet në oborrin e spitalit. Frederiku porositi konjak dhe i kërkon Moikomit cigare. Mos, i them unë. Janë të dëmshme për ty. Ai qesh dhe thërret kamarierin, duke i thënë: edhe një konjak për këtë zotërinë. Unë këmbëngul, që ai s'duhet të pijë konjak, ndërsa Fredi porositi për mua konjak, gotën e të cilit e lë pa e pirë. Kur rikthehem në dhomën e tij, Moikomi i lë mbi tavolinë

një qese me kanatjere, bluza pambuku dhe disa palë çorape. E falenderon Moikomin dhe para se të ikim, kërkon të na shoqërojë deri jashtë dhe kur ndahemi, ulet në lokalin e spitalit dhe porosit prapë konjak dhe ndez një cigare.

TIRANË. 2005. ZYRA E MOIKOMIT NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR.

Është mëngjes dhe sapo hap zyrën time në katin e tretë, dëgjoj zilen e telefonit. Moikomi më kërkon të zbres menjëherë poshtë në zyrën e tij. Eja menjëherë, thotë ai. Zbres me nxitim shkallët dhe nuk e di pse mendja më shkon tek Frederik Rreshpja. Sapo futem në zyrën e Moikomit pyes jo pa shqetësim: Si është Fredi? Sapo fola me të, thotë Moikomi. Më telefonoi nga Kosova. Kërkon që t'i çoj makinën time në Kosovë. Më ka telefonuar edhe Rexhep Ferri, shton Moikomi. Më pas, kur Fredi kthehet në Tiranë, nga rrëfimi i tij marrim vesh se ç'ka ndodhur me të në Kosovë. Është takuar me shumë krijues atje. Rexhep Ferri e ka ndihmuar edhe për qëndrimin në hotel, edhe për ushqimin, edhe për udhëtimin nga Prishtina në Prizren e më pas në Kukës. Për Kukësin flet papushim dhe veçanërisht për shkrimtarin Petrit Palushi... Kam shkruar një roman i thotë Moikomit. E shkrova në Kosovë. E grisa, shton pastaj, e grisa... Kam shkruar në Ministrinë e Kulturës- thotë. Takova atje Ermir Nikën. Sa djalë i mirë, që është...

NË TIRANË. HOTEL. NDOHTA FILLIMVITI, 2006.

Hoteli është në katin e parë të një pallati të vjetër, në një rrugicë të ngushtë, diku pas ish hotel „Pezës”. Trokasim. Derën e hap një grua e moshuar. Është shtrirë Fredi, thotë ajo. Është pa qejf. E gjejmë në dhomën e vogël shtrirë, por sapo na sheh ngrihet dhe si gjithmonë i kërkon Moikomit cigare. Vërtet është shumë i sëmurë, por me një kurajo të çuditëshme. Enver, më drejtohet mua. Mund të më blesh dy qirinj dhe dy paketa? Dal dhe në një market afër ja kryej porosinë. Marr vesh, që i ka vdekur e motra në Shkodër dhe ai nuk ka patur mundësi të shkojë në varrim. Me duart që i dridhen, ndez të dy qirinjtë dhe seç mërmërit nëpër dhëmbë. Ndoshta lutet për shpirtin e të motrës dhe me siguri edhe të nënës, që siç më ka thënë Moikomi, e ka dashur jashtë mase dhe i ka kushtuar një poezi, ndoshta antologjike, nëse një ditë do të botohej një e tillë për nënat...

SHËNIME TË TJERA.

Dy vargje të De Radës:

Frye era e malit
dhe rrëzoi hijen e lisit.

Poshtë vargjeve një shënim i shkurtër:

U rrëzua më në fund një nga lisat e pyllit Deradian, liriku Frederik Rreshpja. Nuk e di se në ç'kohë, por me siguri, pasi ky lis kaloi nga kjo jetë e që quhet Frederik Rreshpja, kam hedhur këto vargje të marra nga librat e tij:

Shi i verbër,
Ti rend t'u kumtosh vetëtimave,
Mënxyrën e dhimbjes sime.

Ca vargje të tjera me një shkëlqim loti dhe dhimbje ulëritëse:

Unë kam qënë trishtimi i botës,
O ajër i mbrëmjes, mbështillëm,
Erdhi ora të vdes përsëri.
...
O ju shpirtërat e pyjeve,
Mbështjellur në dimrin e dhimbjes.

Tiranë - Shkodër, në ca kohë pa kohë, por në kohën e Lirikut të Madh Frederik Rreshpja

ISMAIL KADARE

Një prill për Fredin

(Fragment)

Për Frederik Rreshpjen, poetin shqiptar të shekullit XX, gjithçka ka qenë e vonuar. E tillë, e vonuar, ka qenë hyrja dhe njohja e tij në letrat shqipe, pastaj rikthimi, më saktë njohja e dytë, pas fatkeqësisë komuniste, që ka qenë në radhë të parë fatkeqësia e tij. E kështu me radhë: vlerësimi i tij, që vazhdon të jetë i munguar, e bashkë me të gjithçka për të cilën ka nevojë një poet, duke përfshirë edhe këtë përsiatje, që mund të merret për përshpirtje.

Të jesh i braktisur në letërsi është, pa dyshim, një fatkeqësi. Por ta dish këtë, të jesh i ndërgjegjshëm për të, është dyfish e tillë.

“Më duhet të pranoj se unë kam qenë gjithmonë i braktisur”, ka pohuar ai vetë në vitin 1998. Dhe më pas: “Kam kaluar nga një braktisje te tjetra”.

Në raste të tilla, mendimi i parë që vjen lidhet me ndjesinë e fajit. Faji i vendit ku lindi, i vetë kohës, i një pjese të saj. Më pas, thellimi i mendimit të çon te përfundimi i hidhur se fajin, në të vërtetë, vendi, koha, letrat, ia kanë bërë vetvetes.

Koha ka qenë jo e mëshirshme me Frederik Rreshpjen. Pasi ia mbylli herën e parë portat e saj, e sprapsi për herë të dytë, atëherë kur nuk pritej. Në poezinë e tij, ai kthehet e i rikthehet disa herë kohës. Jo për ta marrë me të mirë, as për t'iu hakërryer: ç'ke që më spraps, por thjesht për t'i kujtuar një gjendje: marrëdhënien e tij me të.

Ishte e natyrshme që poeti me emrin Fredi, emër që ngjante si pjesë e dimrit, t'i drejtohej këtij të fundit me fjalët:

O dimri i drerëve me brirët në erë.

Po orët e harmonisë nuk janë të shpeshta. Edhe kur e dëshiron atë, ka gjithmonë një pengesë midis:

*Dua të bëhem shtator
Të shpërndaj vjeshtën mbi pyje,
Por dëbora...*

Është dëbora që në këtë rast nuk e lë. Dhe në s'do të ishte dëbora, diçka tjetër do ta pengonte mirëkuptimin. Dhe poeti përpara pengesës do ta pranonte humbjen. Pa u brengosur fort se do ta quanin pesimist ose të thyer, ai do të shpallte se fati i kishte ruajtur shumë zymti dhe akull, thënë shkurt: në jetën e tij kishte pasur shumë dhjetor.

Nuk ishte hera e parë që koha e ashpër shqiptare ua mbyllte portat e saj poetëve. Me vite rresht, disa herë me dhjetërvajçarë, ata ngeleshin përjashta, në pritje të orës së hapjes.

Merrej me mend që çastet e rikthimit do të duhej të ishin të tilla që poetët t'i përballonin sa më lehtë. Në rastin e Rreshpjes, poetit që kishte vuajtur aq shumë nga braktisja dhe klima e ftohtë, do të ishte e domosdoshme që rikthimi të bëhej sa më kujdesshëm. Në këtë rast, ky kërkim për klimën e përshtatshme do të mund të përcaktohej si kërkim i stinës së butë, ta zëmë, i muajit prill.

Nisur nga kjo, i gjithë aksioni do të mund të quhej... Një prill për Fredin.

Diku nga fundi i vitit 1972 kam pirë kafën e fundit me Frederik Rreshpjen. Ka ndodhur në Kafe Tirana, një lokal i njohur në atë kohë, ku mblihdeshin zakonisht intelektualët e kryeqytetit. Përveç ne të dyve, në tryezë ishte Todi Lubonja, me të cilin doja ta njihja Rreshpjen, siç kisha bërë me shkrimtarë të tjerë të rinj, që ai, si drejtor liberal i TV-it shqiptar, kishte mundësi t'i ndihmonte.

Frederiku ishte në atë kohë poet i njohur jo pak, një yll në ngjitje, siç thuhej, por pikërisht si i tillë, ngaqë shquhej për shkujdesje, e sidomos për talent të veçantë, ngjante veçanërisht i rrezikuar.

Ndër thënie të qarkullonin për Kafe Tiranën, përmendej ajo e një të çmenduri, i cili e cilësonte si “kafeneja e tri gjysmave”, çka do të thoshte se gjysmën e klientëve, sipas tij, e kishte të çmendur, gjysmën tjetër të dalë nga burgu dhe gjysmën e tretë që do të përfundonte atje.

Më pas, kur për një befasim të keq, Todi Lubonja, mentori i mundshëm i poetit, do të binte në burg, e pas tij vetë poeti, kjo thënie do të kujtohej shpesh. Ishin të dy të burgosur politikë, me të vetmin ndryshim se, ndërsa burgimi i të parit do të ishte i pandërprerë, siç ishin zakonisht dënimet për “cenimin e vijës së partisë”, Frederiku do të kryente dy-tri burgime radhas.

Si shumëçka tjetër, dënimet e poetëve do të ishin të një stili që të kujtonin teatrin absurd. Ngaqë tiranisë shqiptare, ashtu si çdo tiranie, nuk i pëlqente t'i dilte nami se fuste në burg poetët për arsye të poezisë, ajo përpiqej të gjente të tjera vjega. Loja e bixhozit, shthurja morale, homoseksualiteti, e gjer tek akuza për djegie mullarësh të kooperativës, ishin disa nga shkaqet e parapëlqyera.

Dihej se sa e shpejtë dhe e pandalshme ishte në Shqipëri teposhta e një ylli në rënie. Vjershat dhe poemat e tij të bukura u zhdukën nga libraritë dhe nga bibliotekat. Ai vetë, natyrë e vetmuar dhe e pikëllueshme, u bë shumëfish i tillë. Përpara se njerëzit t'i largoheshin, ishte ai vetë që iu shmangej, për të mos iu shkaktuar ndërlikime, siç e ka pohuar vetë në shënimet e tij. Por kjo nuk e pengonte që të vuannte më pak. Dhe këtë më mirë se gjithçka e tregonin vargjet e tij. Gjithçka shkretohej në jetën e tij, venitej, vyshkej, vetëm poezitë i bëheshin më të bukura. Kjo dëshmonte se një harmoni e re po skajtohej në këtë gjendje të re.

*I vrarë nga një pranverë e kotë
Braktisur nga bota e tërë.*

Vërtitej kështu në stinët që ishin të huaja për të, përherë e më i mënjanuar dhe, pa e ditur as vetë, më kërcënues.

Shumë njerëz do të donin të mos e ndeshnin në rrugë. Hetuesit e tij në radhë të parë, gardianët e burgut, dëshmitarët e rremë, pa dyshim, por më tepër se këta, letrarët që kishin brohoritur arrestimin e tij. Në çdo socializëm do të kishte të tillë, por në Shqipëri ata ishin më të shpeshtë se kudo.

Ai ishte mësuar me këtë, ashtu siç e dinte se gjithë ky fat i mbrapshtë i vinte nga letërsia. Dhe siç ndodhte shpesh me njerëzit, që, nga dashuria e tepërt, kalonin në mohimin e saj, i pëlqente të ngacmohej pikërisht për letërsinë. Në shënimet e fazës së fundit të jetës gjendeshin fraza të tilla, si “*unë hyj ndër ata shqiptarë që nuk kanë lexuar asnjë rresht të botuar nga F. Rreshpja*”.

E dinte që jo vetëm nuk ishte ashtu, por ishte e kundërta. Letërsia kishte qenë në të vërtetë fati i tij, por me të dy anët e veta: i mirë dhe i keq. Dhe kjo ia bënte të natyrshme perifrazimin e thënies së Jezusit, se secilës ditë i mjaftonte pikëllimi i vet.“*Çdo ditë ka dhjetorin e vet dhe kjo i mjafton*”, do të shkruante pak përpara fikjes së tij.

E gjelbra e tyre është një lloj brenge

poezi nga
PHILIP LARKIN
Përktheu Kujtim Morina

Ditët

Për çfarë janë ditët?
Ditët janë aty ku ne jetojmë.
Ato vijnë, na zgjojnë
përsëri e përsëri.
Ato janë për të qenë të lumtur:
Ku mund të jetojmë përveçse në ditët?

Ah, përgjigja e kësaj pyetjeje,
të bësh bashkë priftin dhe doktorin
me palltot e tyre të gjata
duke vrapuar nëpër fusha.

S’ka rrugë

Qysh kur ramë dakord ta lëmë rrugën ndërmjet nesh
të shkojë drejt mospërdorimit,
i zumë me mur portat, mbollëm pemë për të zënë pamjen
dhe i lamë të gjithë agjentët e gërryerjes së kohës të lirë,
heshtjen, hapësirën dhe të panjohurit, kjo shpërfillje
nuk qe ndonjë zgjidhje.

Gjethet bien të pafshira, mbase bari kacavaret i pakositur;
Asnjë ndryshim tjetër.
Aq e pastër qëndron rruga, kaq pak e mbushur,
të ecësh asaj rruge sonte nuk do të dukej e çuditshme
dhe ende do të lejohej. Edhe pak të presim
dhe koha do ta bëjë të veten.

Të skicosh një botë ku asnjë rrugë nuk shkon
mes meje e teje;
Ta vështrosh atë botë që shfaqet si një diell i ftohtë,
duke shpërblyer të tjerët, është liria ime.
Të mos e pengoj është përmbushje e vullnetit tim
Ta pranoj atë, dobësia ime.

Ky të jetë vargu

Të luajnë mendsh, nëna dhe babai.
Mund të mos e kenë me qëllim por e bëjnë.
T’i veshin të metat që ata vetë i kanë
dhe pa shtuar disa të tjera nuk të lënë.

Por ata vetë janë luajtur nga fiqiri më parë
nga budallenj me kapele dhe xhaketa të vjetra,
të cilët gjysmën e kohës ishin qullacë, të vrazhdë,
dhe gjysmën tjetër në grykët e njëri-tjetrit.

Njeriu ia kalon mjerimin njeriut
dhe ai thellohet si guma e bregdetit.
Dil prej tij sa më shpejt të mundesh
dhe mos bëj fëmijë edhe ti ta përcjellësh.

Aubade*

Punoj gjithë ditën dhe jam gjysëm i dehur natën
Duke u zgjuar në katër në errësirën e frikshme, vështroj
Me kalimin e kohës, cepat e perdeve fillojnë e zbardhen
Derisa shoh çfarë ka me të vërtet aty gjithmonë:
Vdekja e paepur, një ditë e tërë më afër tani,
që e bën të menduarit të pamundur po si
dhe kur e ku do të vdes edhe unë.
Pyetja e vjetër: megjithatë frika e vdekjes
dhe të qenit i vdekur
vezullon rishtas dhe qëndron e më tmerron.

Mendja përhumbet nga drita. Jo me pendim
për të mirën e pabërë, dashurinë e padhënë
kohën e ikur të papërdorur –as në mjerim sepse
një jetë e vetme do kaq shumë kohë të ngjitet,
lirohet nga fillimet e gabuara, mund të mos ia arrijë kurrë
veçse në zbrazëtinë totale herdokur.
Zhdukja e sigurtë drejt së cilës shkojmë
ku do të humbasim përgjithmonë, Për të mos qenë këtu,
për të mos qenë askund
dhe shpejt, asgjë më e tmerrshme, asgjë më e vërtetë.

Kjo është një ditë e veçantë e të qenit i frikësuar.
Asnjë truk nuk e davarit. Besimi fetar përpigjej,
ajo brokadë e madhe me fije argjendi e kohës së shkuar
krijuar për t’u shtirur që ne kurrë nuk vdesim,
dhe gjëja e rrejtshme që thotë: Asnjë qenie e arsyeshme
s’mund të ketë frikë nga një gjë që nuk e ndien, edhe pse
është pikërisht ajo gjë që i frikësohemi- as shikim, as zë,
as prekje, as shijim e as nuhatje, asgjë për tu menduar,
Asgjë që na lidh me të apo për tu dashuruar
Anestezia nga e cila asnjërit nuk i merren mendtë.

Kështu ajo qëndron mu në kufi të vizionit,
një turbullirë e vogël e pafokusuar, ftohje e përhershme
që ngadalëson çdo impuls drejt pavendosmërisë,
shumica e gjërave mund të mos ndodhin kurrë, kjo mundet.
Vetëdijësimi i saj shpërthen
me frikën e furnraltës kur na gjen
pa njerëz ose pije. Guximi nuk bën dobi;
Do të thotë të mos trembësh të tjerët. Të qenit trim
nuk mban askënd larg varrit
Vdekja nuk është e ndryshme me rënkime sesa me durim.

Ngadalë drita forcohet dhe dhoma merr formë.
Qëndron e dukshme si një garderobë, çfarë dimë,
e kemi ditur gjithnjë, e dimë që s’mund t’i shpëtojmë,
megjithëse nuk e pranojmë. Njëra palë duhet të ikë.
Ndërkohë telefonat kërrusen, gati për të cingërruar
në zyra të kyçyra dhe e gjithë bota e ndërlikuar,
mokokëçarëse, e marrë me qira, fillon të zgjohet.
Qielli është i bardhë si argjila, pa diell
punët duhen bërë.
Postierët si doktorët nga shtëpia në shtëpi shkojnë.

•Aubade- një poezi ose pjesë muzikore e shkruar për mëngjesin
e hershëm.

Paraja

Çdo tre muaj kështu, paraja më qorton:
përse më lë këtu të qëndroj fare kot?
Jam ajo që s’e ke pasur kurrë për mall dhe seks.
Ende mund të nxjerrësh diçka duke shkruar disa çeqe.

I shikoj të tjerët, çfarë bëjnë me të tyret:
Ata me siguri nuk i mbajnë në sëndyqe.
Tani kanë një shtëpi të dytë, makinë dhe grua:
e qartë se paraja ka të bëjë me të jetuarit.

Në fakt, ato na duhen të gjithëve, nëse heton:
s’mund ta shtysh rininë derisa të dalësh në pension,
megjithëse shtrëngon vidhën, paratë që kursen
në fund me një blerje t’i rruanë menjëherë.

Dëgjoj tingëllimën e parave, si të shikosh nga lart
nga dritaret e gjata të reja një qytet provincial.
Lagjet e varfëra, kanalin, kishat e stolisura dhe rrëmbyese
në diellin e mbrëmjes. Është jashtëzakonisht trishtuese.

Mashtrimi

“Natyrisht se isha droguar dhe kaq rëndë sa nuk më erdhi
vetëdija deri mëngjesin tjetër. U lemerisa kur e kuptova se isha
e rrënuar dhe për disa ditë e pangushëllueshme dhe qaja si një
fëmijë që do të vritej apo kthehej prapë tek tezza”—Mayhew,
London Labour and the London Poor. (Ky pasazh vjen nga një
grua e re që ishte përdhunuar, shënim i përkthyesit).

Megjithëse kaq e largët, mund ta ndjej brengën
e hidhur dhe e ashpër me nyje, ai të bëri ta gëlltitësh
drita e rastësishme e diellit, ritmi i shpejtë
nga zhurma e rrotave jashtë në rrugë, i mërzitur
ku Londra nuse përkulet në mënyrë tjetër
dhe drita, e papërgjigje, e gjerë dhe e gjatë
e pengon varrën të shërohet dhe nxjerr
turpin nga skuta. E gjithë dita vjen përtace,
mendja jote si një sirtar thikash hapet.

Lagjet e varfra, vitet, të kanë groposur. Nuk do të guxoja
të të ngushëlloja nëse do të mundja. Çfarë mund të thuhet,
përveç se vuajtja është e përpiktë por
kur bëhesh rob i dëshirës, leximet dalin të gabuara?
Sepse vështirë të të shkojë mendja
se ishit më pak e mashtrua, mbi atë shtrat,
sesa ishte ai, duke u penguar shkallëve pa frymë
për të shpërthyer në garsonieren e shkretë për pak rehat.

Kositësi

Kositësi ndaloi, dy herë; duke u gjunjëzuar,
gjeta, tha, një iriq të ngecur në teh të kosës, të vrarë,
kishte qenë në barin e gjatë.

E kisha parë atë më parë dhe madje ushqyer njëherë.
Tani e kisha copëtuar botën e tij të patrazuar
në mënyrë të pandreqshme, Varrimi nuk sjell dobi.

Mëngjesin tjetër unë u zgjova, ai jo.
Dita e parë pas një vdekjeje, një mungesë tjetër.
Është gjithnjë kështu; duhet të jemi të kujdesshëm

me njëri-tjetrin, duhet të jemi të sjellshëm
kur ende ka kohë.

Pemët

Pemëve po iu dalin gjethet
si diçka që sapo nxjerr fjalë;
gonxhet e sapodala zbuten dhe hapen,
e gjelbra e tyre është një lloj brenge.

A vjen kjo ngase ato po rilindin
ndërsa ne po plakemi?
Jo, ato vdesin gjithashtu.
Rrengu i tyre i përvitshëm të rinj për t’u dukur
është i shkruar poshtë në rrathët e trungjeve.

Megjithatë edhe kështjellat e pamposhtura lëkunden
çdo maj në trashësinë e tyre të plotë.
Viti i kaluar është i vdekur, duket se thonë,
fillo rishtas, rishtas, rishtas.

PHILIP LARKIN (1922-1985), është ndër poetët
më përfaqësues dhe të vlerësuar lart që i dha zë një
ndjeshmërie të fortë antiromantike që mbizotëroi në
poezinë angleze në vitet 50 të shekullit XX.

Larkin ndoqi studimet në Universitetin e Oksfordit,
një përvojë që ai e shfrytëzoi për romanin e tij të parë
“Jill” (1946). Libri i tij i parë me poezi “The North
Ship”(Anija e Veriut) u botua me shpenzimet e tij më
1945. Një roman tjetër, “A Girl in Winter” (Një vajzë në
Dimër) e pasoi më 1947. Ai u bë i njohur me “The Less
Deceived” (Më pak të Mashtruarit) 1955, një vëllim me
poezi, titulli i të cilit nënkupton reagimin e Larkin dhe të
shkrimtarëve të tjerë britanikë që tërhoqën vëmendjen
si Kingsley Amis dhe John Wain kundër entuziazmit
politik të viteve 30 dhe çfarë ata i konsideronin si
tejkalime emocionale të poezisë së viteve 40. Vargu i
tij nuk është pa emocion por ai tenton të mos shfaqet
direkt.

Larkin u bë bibliotekar në Universitetin Hull në
Yorkshire më 1955 dhe ishte gjithashtu edhe gazetar i
kritikës për xhaz në The Daily Telegraph (1961–71). “The
Whitsun Weddings” (Dasmat e Rrëshajës)1964) dhe
“High Windows” (Dritare të Larta) 1974, janë vëllimet
e tij të mëpasme me poezi. Ai ka redaktuar “The Oxford
Book of Twentieth-Century English Verse” (Antologjia
e Oksfordit e poezisë angleze të shekullit XX), 1973.
Ndërsa “Required Writing, (Shkrimi i duhur),1982, është
një përmbledhje me ese të ndryshme të tij.



Arie e një të shastisure

poezi nga

ALISA VELAJ

KY QIELL

Ky qiell i vrenjtur përmbi Kopenhagë
atdhe i papritur hieroglifesh ikanake
do t'më përmendë mua
do të të rikujtojë ty
se të flasësh për moskuptime gjuhësh, kombesh, racash
s'është asgjë më tepër se bjerrje kuptimi
e atit tënd flegmatik që inatosen pse yt bir
qahet për asgjë pas një gote birrë
dhe s'është kurrë i pathyeshëm si një viking!

Është njëlloj i kuptueshëm ky qiell hieroglifesh
sa retorika e fëmijëve tuaj për humanizmin
drejtuar njerëzve që s'e jetuan kurrë paqen
aspak pse nuk deshën
aspak pse nuk ditën...

I vetmi alfabet që s'na e mësoi kush
(Dhe i shpërfill pa dashje tërë retorikat)
janë sytë e tu të thellë që mbetën në mua
ndoshta pa e ditur se ishin nisur për udhë...

Dhe koha kalon, kalojnë stinët
kalon çdo çast si një tingull pianoje
që ndihet pas bredhave të një parku dimëror.

Ne festojmë ndarjet, dashuritë, pendesat, harrimet
pastaj një grimëkohë i këndojmë mospranisë
me fjalët më të ëmbla që kurrë nuk i zgjodhëm...

Unë të dua ty më shumë se dashurinë
të dua me marrinë e trungjeve që ëndërruan diellin
ndërsa ai u shkelte syrin dhe nisej për tjetërkund...

Të dua përtej kuptimeve që lodhin racën njerëzore
Si ndodhi? Pse erdhi? Ku shkoi? A do të kthehet?
Ti dhe në mos ndodhsh, je i kudondodhur
asnjëherë në mos ardhsh, s'ke kurrë për të shkuar
prej meje, prej qiejve dhe asaj stine
që veç unë ia njoh shenjat!

Ti i sapokrijuari hieroglif
nën një qiell të bukur
larg tokës ku ecën si kalimtar...

ARIE E NJË TË SHASHTISURE

pas dy gotash xhin

(Skotit iu deshën dhjetë vjet që ta kuptonte se Zelda ishte e çmendur.
Marrë nga "Një festë që e ke gjithnjë me vete", Ernest Heminguej)

Hej Skot,
i treti xhin që po rrëkëllen sonte!
Trinia s'është bekim në përgjumjen e trurit.
Unë dhe ti iu lutëm Jezuit për çdo here
dhe ndoqëm udhë të gabuara prej fillimit.
Lëmshi i Ariadnës fati im dhe yti...

Hija e Zeldës sërish të endet bebëzave
ashtu si pa kokëçarje
si pa asnjë pendesë...

Pendestarë janë shpirti im dhe yti, Skot,
për të pamundurën që s'e kuptuam kurrë
dhe sytë tanë të verbër për të parë errësirën,
ku ecin majtas-djathtas ca genie të çoroditura,
me sy, rrashtë e ashtë, sikundër krejt njerëzia.

Të betohem, për shpirt të të shtatë kryeengjëljeve, mik,
(Zoti më faltë kur nuk kam fuqi
të nxij a të zbardh asnjë fije floku)
për shpirtin e tyre të betohem, Skot,
Zelda ishte bijë e motër imja.
Po s'e ishte nënë unë nuk e dija, i dashur,
nuk e dija!

Bijës suaj të parëlindur,
farës tënde të frymëzimit dhe përhumbjes së saj
qiellin s'ia mësuam dot as si nostalgji...

Mahnitur fushave, ku këngën bilbilave s'ua ndal askush,
vogëlushja e mjerë i trembej dritës,
njëjtë si zogu i lindur në kafaz, lirisë.

Këtë doja të të thosha sonte, Skot, këtë doja,
ndërsa kam mbaruar xhinin tim të dytë,
e ti më sheh me sy të ndezur nga kërshtëria.

Do doja të bëja një herë dashuri me ty, Skot,
për hir të pasionit tonë të sëmurë.
Pastaj të dy do të flaknim njëherë e mirë prej shpirtit,
këngën e Zeldës dhe shijen e asgjësë...

ARIE TË PURPURTA PËR NJË LULE-ZJARRI

...
Jam krejt lule-zjarri
kur disku i diellit
digjet pas ishullit
në perëndim...

...
Çdo muzg është vejan
pa një lule zjarri.

...
Mjegulla mbi luginë
s'e fsheh dot lule-zjarrin...

...
Të prita sa herë muzgjeve
më pa një lule-zjarri.

...
Tri lule-zjarri
janë tri premtime
në pyllin e vetmisë.

..
Më fal një lule-zjarri
t'u jap lamtumirën
netëve boreale.

..
As korbi më kryeneç
s'e sheh dot në sy lule-zjarrin.

...
Vetëm Feniksi
u preh mbi lule-zjarrin
deri në amëshim...

PRELUD

Pas asaj dere të mbyllur ti mund të jesh
dëshmitari i parë i ardhjes së pranverës,
ose i mbrami i vrapimit të vjeshtës.

Qëndron aty më i heshtur se pemët.
E di se nuk duhet të trokasësh dhe s'e bën.
Vështron shtëpinë e fshehur pas drurëve.
Ndjen si disa tinguj të shtriqu në kraharor
dhe befaz nuk do të ikësh, por as të rrish.

Tingujt vazhdojnë të shtriqu edhe më.
Kërcet kraharori yt si hapat mbi gjethet e zverdhura.
Ti i sheh drurët e zhveshur me dashuri
e të duket marrëzi që vetmojnë
pas një porte të blertë...

Dy hapa prapa dhe merr udhën e kthimit,
pa marrë mundimin as të trokasësh në atë derë.
Trembesh mos i zgjon meloditë brenda vetes
në një strehë që nuk e dite kurrë,
në do të jetë e jotja apo e tjetërkujt.

E kraharori yt zgjerohet sa klithma e pulëbardhës,
ndërkohë që ti ecën e ecën mes një pylli,
në fund të të cilit fshihet deti yt,
bir drite!

AKULL REBEKA, AKULL

Rebeka, akull motër, akull!
Mespërmes harrimit ata luajnë me flaut.
Janë një, dy, tre, njëqind...
Tinguj frymorë që nuk kanë të sosur.
Po ngrohtë nuk bën, bora nuk bindet.
Duart tona s'janë as prej zjarri, as prej mjaliti,



t'i thonë ndal fymës së tingullt
që bie degëve të zhveshura
e bëhet zog akulli.

Akull, motra ime, akull!
Akull simfonitë që lindin mollëzave.
Të rrejshme sa për pak tingujt e mushkërive.
Ç'ka ndodhur, e mira ime, ç'ka ndodhur,
të braktisemi kaq gjatë nga dielli i mosmirënjohjes?

Çfarë teproi dhe qe ende pak,
për ta mbajtur prushin ndezur der në ag,
edhe kur të ftuarit e fundit ikën një nga një?
Apo pas gostisë secili mori fshehtas pak zjarr,
duke ia mbathur rishmëz prej andej nga erdhi?

Mbetën pastaj të akulluar si ne dhe ata.
As flaka e mbetur, as ajo e vjedhur
s'na e ngrohu kurrë shpirtin!

Akull, bija ime, akull!

VEZË

Rebeka e do përherë mëngjesin ashtu.
Çohet pagdhirë, duke vështruar mjellmat tek flenë,
me kokën fshehur tërësisht mes krahësh.
Ato duken si vezë të stërmëdha bregut të liqenit.
Ajo i vështron tek qëron vezën e saj të parë,
ndërsa e dyta llokoçitet në zjarr.

Zhvesh përtueshëm lëvozhgat me një ritual të përpiktë,
hedh sytë drejt liqenit dhe përmallet.
Mjellmat fillojnë zgjohen një nga një.
I njëjti vakt përherë i pandryshueshëm...

Herë-herë ajo shijon vezë e sheh mjellma
në gjumin e saj të natës.
Brof si e ndërkryer prej ëndrrës,
del në ballkon ku rigon një shi i hollë si lëngim,
zilepset me ujin e liqenit në heshtjen e natës
dhe ia kris të qarit...

PEMË ARRE

Të kujtohet Rebeka?
Ish stina e korrijeve dhe arrat në pemë,
bërë sa grushti i foshnjës sate motake.
Tjerë familjarë rreth trungut të gjerë
(aq të gjerë sa për një shtëpizë shpirtërash të humbur),
vështronin degët, frutet e saj të bollshme,
ngjiteshin si ketra majë saj të shkundnin degët,
gjersa kokërr arre nuk mbetej në to.

Pastaj frytet mblidheshin në kanistra,
vinin pasditet e dashura plot aromë xhenxhefli,
keku me arra, tortat me arra...
Mbrëmjeve kalamendeshim mes aromave e bollëkut!

Kish arra përherë e më shumë.
Binin përdhe gjatë natës kur ne dot s'i shihnim.
Shpendët grabitqarë i përlanin saora
dhe ishin të lumtur po edhe ne.

Me siguri e mban mend Rebeka,
se arrat filluan të pakësoheshin kur shpendët erdhën.
Plot nervozizëm ngjitnim fëmijët ndër degë,
po trumat e grabitqarëve s'i ndalëm që s'i ndalëm!

Kaluan vite e rrodhën kaq ujëra.
Çdo stinë korrijeje pati frutat e veta.
E vetmja gjë që më vërtitet kujtesës,
janë arrat sa grushti i vajzës sate motake,
që sot në të tridhjetë pranverat e saj,
metropoleve tek udhëton të njohë Europën,
është mirë të dijë diçka për atë stinë korrijesh
dhe trishtimin tonë të pafuqishëm
ndaj shpendëve grabitqarë!



Muriel Spark

VITI I PARË I JETËS SIME

Tregim

Përktheu: Aristidh Shqevi

Unë erdha në këtë botë ditën e parë të muajit të dytë të vitit të fundit të Luftës së Parë Botërore, një të premtë. Ka dëshmi të bollshme se gjatë vitit të parë të jetës sime unë nuk buzëqesha kurrë. Më njihnin si foshnja, të cilën asgjë dhe askush nuk mund ta bënte të buzëqeshte. Të gjithë personat që më kanë njohur në atë kohë ma kanë pohuar këtë. Ata u përpoqën shumë, këndonin, më hidhnin lart e poshtë si të isha një top, kërcenin rreth e qark, ngërdhesheshin. Vite më vonë, anëtarë të familjes, por edhe miqtë e tyre ma kanë rrëfyer këtë shumë herë; por unë, të gjitha këto i kam ditur vetë që në kohën kur isha foshnjë.

Së shpejti do të dëgjoni të flitet për atë shkollën e re të psikologjisë për të cilën edhe mund të keni dëgjuar se pas kërkimeve dhe eksperimenteve të gjatë dhe aspak të lehtë, ajo ka vërtetuar se të gjitha foshnjat e gjinisë njerëzore lindin të gjithëdijshe. Foshnja të porsalindura që dinë gjithçka që ndodh kudo në botë; ato kanë aftësinë për të kuptuar çfarëdolloj bisede

që dëshirojnë të ndjekin dhe të lidhen me gjithfarë mjedisi. Ne të gjithë e kemi provuar këtë fuqi. Fuqi që na shpëlahet nga truri vetëm pas një viti që kemi ardhur në jetë. Sepse na kërkohet nga ambienti rrethanor që të rritemi për t'u bërë të dobishëm në një mënyrë praktike. Gradualisht qelizat e gjithëditura të trurit tonë pësojnë ndërprerje në komunikim, ndonëse triva të tyre mbeten te disa individë në formën e ESP-ës, gjë që ndodh edhe me të rriturit në disa fise primitive.

Kjo nuk është teori e re. Poetë dhe filozofë, si zakonisht, i kanë ditur këto që në fillim të herës. Prova shkencore ekziston dhe madje ajo është e disponueshme. Ndoshta dora e fundit është duke u hedhur te disa qeliza në Universitetin e Harvard-it. Nga ky moment e këtij manifesti i ri do t'i jepet botës, dhe bota do të kandiset.

Më lejoni atëherë që së pari të shprehem, sepse tani jam shumë e sigurt për mirëfillësinë e kujtesës sime në lidhje me ndodhitë e së kaluarës. Autobiografia ime,

siç edhe fare mirë e perceptova atëherë, nisi në vitin më të lig që bota kishte njohur deri në atë moment. Përveç faktit që kisha lindur pa dhëmbë dhe dergjesha në shtrat, i paaftë për t'u ngritur mbi jastëk a për të thënë diçka me përjashtim të këllhitjeve të çjera si ato të zogjve në oborrin e një ferme ose ulërimave të ngjashme me sirenat e makinave të policisë, me fshikëzën e urinës dhe zorret e brendshme tërësisht jashtë kontrollit, unë pezmatohesha edhe më shumë nga sjellja e sisorëve dykëmbësh që kisha përçark. Ata ishin njerëz të veshur me rroba të zeza, femra të një specie së cilës mesa dukej i përkisja dhe unë, dhe që thonin se kishin humbur bijtë e tyre. Unë flija vërtet shumë. Ato ama ishin të lira të shkonin dhe t'i gjenin bijtë e tyre. Ashtu siç herë pas here humbte ajo karfica e posaçme e pelenave të mia që nëna ime a ndonjë dado ia përkushtonte kujdesit tim. Këto gra të shkujdesura të veshura me të zeza humbnin burrat dhe vëllezërit e tyre. Më pas vinin në shtëpinë tonë për t'i bërë vizitë mamasë ku edhe kakarisnin e klithnin mbi djepin tim. Unë, nuk zbavitesha aspak.

'Në të vërtetë foshnjat nuk buzëqeshin pa mbushur tre muaj,' tha nëna ime. 'Dhe madje as që duhet të buzëqeshin pa u bërë tre muajsh.'

Vëllai im, gjashtë vjeçar, ecte lart e poshtë me hap ushtarak me një pushkë lodër të hedhur mbi njërin sup:

*Duka i Madh e i moçëm i York-ut
Dhjetë mijë ushtarë dispononte;
I urdhëronte të ngjiteshin në majë të kodrës
Dhe i zbriste poshtë sa herë që donte.*

*Kur ishin lart, ata ndodheshin lart.
Kur ishin poshtë, ata ndodheshin poshtë.
Tek ngjiteshin lart.
Nuk zbrisnin poshtë.*

'Dëgjoni!
'Pa shikojeni pak, ai ka dhe një pushkë mbi krah!'

Kishin kaluar dhjetë ditë nga çasti që kisha parë dritën e diellit, kur Rusia u tërhoq nga lufta. U sintonizova me Carin, tashmë një i burgosur, dhe pjesën tjetër të familjes së tij, meqë atdheu dukshëm e kishte shkurorëzuar, sepse shumë kohë përpara se të lindja unë aty kishte ndodhur një revolucion. Të gjithë kishin në gojë atë ngjarje. Unë u sintetizova me Carin. 'Asgjë nuk do të më detyronte ta nënshkruaja Traktatin e Brest-Litovsky-t,' i tha ai së shoqes. Gjithsesi, askush nuk ia kishte kërkuar ta bënte këtë.

Në këtë periudhë unë flija njëzetë orë në ditë për t'u forcuar. Dhe nga ato që vija re gjatë katër orëve të tjera e dija se kjo që po bëja do të më vlente në të ardhmen. Fronti i Perëndimit në frekuencën time ishte vetëm gjak, baltë, trupa të bëra kortarë- kortarë, përplasje dëmprurëse, flakërima të ethshme dritash nën qiellin e errët, shpërthime, terror total. Meqenëse ishte e qartë se kisha lindur në një moment të papërshtatshëm të historisë botërore, e ardhmja më shqetësonte, sepse unë nuk isha në gjendje ta ngrija kokën nga jastëku dhe gjatësia ime nuk i kalonte pesëdhjetë e një centimetrat. 'Me të vërtetë do të dëshiroja që të isha një dhëlpër ose një zog,' D. H. Lawrence i shkruante dikujt. O Jezu i trishtë, i moçëm e rrëqethës! Më zuri gjumi.

Çarçafë të përgjakur e të përflaktë çanë përmes qiellit. Kalandari shënonte 21 mars, dita e pesëdhjetë e jetës sime; ndërkohë Ofensiva Gjermane e Pranverës kishte filluar përpara se unë ta merrja ushqimin e mëngjesit. Kasaphanë e pafund. Tek pashë atë skenë u vrenjta në fytyrë.

Dhe bëra një përpjekje të reagoja fuqishëm. Por përpjekja ishte e dobët. I xhindosur, dhe në pritje të ankthshme për të rimarrë forcat, ulërita për ushqim. Pas ushqimit ndërpreva ulërimën, por vazhdova të qëndroja në vrenjtur.

*Duka i Madh e i moçëm i York-ut
Dhjetë mijë ushtarë dispononte...*

Ato tundnin djepin. Kurrë nuk dëgjova një këngë më të pamend se kjo. Përtej, në Berlin dhe në Vienë njerëzit vdisnin nga uria, ngrinin nga të ftohtit, bënin greva, rebeloheshin, sokëllinin me të madhe nëpër rrugë. Në

Londër të gjithë nguteshin për në punë dhe hungëronin se kishte ardhur koha që gjithë atij mallkimi të madh t'i vinte fundi.

Të rriturit përreth meje zbardhnin dhëmbët; kjo nënkuptonte buzëqeshje, por edhe se ata ishin të kënaqur dhe në qejf. Flisnin për triska mishi, sheqeri dhe gjalpi.

‘Ku do të përfundojë e gjitha kjo?’

Rashë për të fjetur. U zgjova dhe u sintonizova me Bernard Shaw, i cili po i thoshte të gjithëve ta qepnin gojën. Pastaj kalova tek Joseph Conrad-i, i cili çuditërisht ishte duke thënë të njëjtën gjë. Pata mendimin se nuk ia vlente të buzëqeshja, ndonëse diçka e tillë pritej nga unë nga dita në ditë. Më pas u hodha në Turqi. Gra të veshura në zi mblidheshin dhe llomtisnin në harem in e tyre; bla-bla-bla. Ishte një gjë e mërzitshme, ndaj dhe u ktheva në bazën time në shtëpi.

Gra të veshura në zi të një versioni britanik hynin e dilnin nga shtëpia. Vëllai i mamasë, i veshur me një uniformë ushtarake, u fut brenda duke kollitur. Ai ishte helmuar nga gazi në llogore. ‘*Tout le monde à la bataille!*’ thërriste me një ton të ngritur Marshalli Foch, plakushi ndyrësirë, Komandanti i Përgjithshëm i Forcave Aleate. Xhaxhai u kollit nga thellësia e mushkërive, nga të cilat nuk u shërua kurrë, por pavarësisht nga kjo, ai ishte i destinuar për në front. Kopsat e tunxhta të uniformës feksnin nga reflektimi i zjarrit të oxhakut. Tashmë unë peshoja pesë kilogram e gjysmë; duke parë se jetën e kisha përpara dhe se më duhej të përballoja gjithë këtë turmë, tendosa trupin dhe lëshova disa shkelma. Më ushqenin gjashtë herë në ditë, por ushqimin nuk e nxora asnjëherë deri në momentin kur *Vindictive* u fundos në portin e Ostende-s, ditë kjo në të cilën unë shkelloja me një forcë të veçantë tek bëja banjë.

Në Francë, ushtarët nën armë kalonin mbi të vdekurit sa herë që hidheshin në sulm tek mbushnin fushat e betejës me gjymtyrë e duar, ose mbyteshin në baltë. Burrat më të fuqishëm kishin humbur jetën në të gjitha frontet përpara se unë të lindja. Shërbimi i rojës përdorte trupat e pajetë për të ngritur barrikada, ndërkohë që luftëtarët nuk gëzonin shëndet të mirë që në krye të herës. Unë kontrollova gishtat e këmbës dhe të duarve duke e ditur se do të kisha nevojë për to. *The Playboy of the Western World* ishte vënë në skenë te Court Theatre në Londër, por herë-herë unë lidhesha direkt me Dhomën e Komunave, e cila më vinte në gjumë pa e kuptuar fare. Në përgjithësi unë preferoja Frontin Perëndimor ku ishte e mundur ta mësoje se çfarë po ndodhte në të vërtetë. Ishte thelbësore që të kishe dijeni për të gjitha të këqijat, gjakun, shpërthimet dhe gjithçka, sepse duhej të përgatiteshe, ashtu siç thonin edhe Boyskautët. Virginia Wolf-i gogësiu dhe zgjati dorën drejt ditarit të saj. Ishte e vërtetë, unë preferoja Frontin e Perëndimit.

Në muajin e pestë të jetës isha në gjendje ta ngrija kokën nga jastëku dhe ta mbaja atë lart. Sendet që m'i jepnin i mbërtheja në dorë pa vështirësi. Disa prej tyre rrapëllinin e trokëllinin. Unë i breja ato me qëllim që të filloja e t'i vija dhëmbët në përdorim. ‘Akoma nuk ka buzëqeshur?’ pyetën hallat e zymta. Mamaja, e tërhequr në mbrojtje, tha se kishte mundësi që unë të isha një nga ato fëmijët që buzëqeshin vonë. Në gjatësinë e valës sime Pablo Picasso po martohej, kurse në fillim të korrikut në katedralen e Shën Pavlit u festua me një ceremoni të hareshme përvjetori i argjenditë i dasmës së mbretit George V dhe mbretëreshës Mary. Ata shëtitën me makinë përmes rrugëve të Londrës bashkë me fëmijët e tyre. Njëzetë e pesë vite lumturi familjare. Një zhurmë e madhe u bë për dorëzimin ceremonial të shpatave në Guildhall ku mbreti dhe mbretëresha morën një çek me vlerën e pesëdhjetë e tre mijë sterlinave për t'i përdorur në vepra bamirësie sipas dëshirës së tyre. *Tout le monde à la bataille!* Tatimi mbi të ardhurat në Angli kishte shkuar në gjashtë shilinga për një stërlinë. Të gjithë flisnin për Përvjetorin e Argjenditë, bla-bla-bla, ndërsa dhjetë ditë më vonë, Cari dhe familja e tij, tashmë në Siberi, u ftuan që të zbrisnin në një dhomë të vogël në qilar. Bam, bam, buçitën armët; klithje dhe gjak kudo për qark, gjë që shënoi kështu dhe fundin e familjes Romanoff. Unë shtrëngova muskujt. ‘Një fëmijë i bukur e i shëndetshëm,’ tha doktori, gjë që më dha një kënaqësi të madhe.



Tout le monde à la bataille! Këtu përfshihej edhe xhaxhai im i helmuar nga gazi. Shëndeti im ishte përmirësuar deri aty sa isha në gjendje të hiqesha zvarrë deri te rrethorja. Brendan Russell-i me gëzim vazhdonte të qëndronte në burg sepse kishte shkruar diçka subversive në favor të pacifizmit. Pas sintonizimit, si zakonisht, me linjën e frontit dukej sikur gjermanët po i fitonin të gjitha betejat, por megjithatë ata po e humbnin luftën. Dhe kështu ishte. Ata që kishin fitime të mëdha vjetorë ishin të shqetësuar nga tatimi i ri mbi të ardhurat, gjashtë shilinga për një stërlinë. Sidoqoftë, të gjitha gratë mbi të tridhjetat fituan të drejtën e votës. ‘Do të më duhet të pres shumë kohë,’ tha njëra nga hallat e mia plakushe dhe fytyrëngrysur. Fjalimet në Dhomën e Komunave si gjithmonë më vinin në gjumë dhe kjo ishte arsyeja që nuk arrita të kap në kohën e duhur njëfarë fjalimi prej oratori të zotit Asquith me rastin e armëpushimit të njëmbëdhjetë nëntorit. Zoti Asquith ishte një ish kryeministër shumë i vlerësuar, i cili më vonë mori titullin e kontit; ai ishte dëbuar nga posti prej zotit Lloyd George. Unë e kisha dëgjuar qartë Asquith-in tek i referohej zotit Lloyd George me fjalët ‘ai çjapi i mallkuar nga Uells’.

Armëpushimi u nënshkrua në kohën kur unë isha zgjuar. Arrita të ngrihem në këmbë me ndihmën e shufrave të shtratit. Sipas mendimit tim, dhëmbët po më dilnin shumë bukur dhe ia vlente barra qiranë që t'i kaloja të gjitha ato mundime për t'i nxjerrë të gjithë. Tani peshoja nëntë kile. Në të gjitha frontet e luftës nëpër botë, të vrarët në luftim e sipër bashkë me ata që kishin humbur jetën nga plagët, kishin arritur shifrën tetë milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë, ndërsa luftëtarët e plagosur dhe të gjymtuar kishin mbërritur shifrën njëzetë e një milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy. Me këto shifra në kokë u ula në karrigen time të lartë dhe përplasa me forcë lugën mbi tavolinë. Një nga mikeshat e mamasë, e veshur me rroba të zeza, recitoi:

Me Vdekjen unë kam lënë takim

Në barrikada të vëna në dyshim,

Me t'u kthyer pranvera me gjethet që nën hije fëshfërijnë

*Dhe lulet e mollës që ajrin mbushin me gëzim,
Unë me Vdekjen kam lënë takim.*

Thuhej se shumica e poetëve ishin vrarë. Poezia i bënte ata t'i njomnin sytë me shamitë e tyre të bardha e të pastra të dorës.

Në shkurt, me rastin e vitit të parë të ditëlindjes sime, më sollën një kek me një qiri. Për vizitë erdhën shumë fëmijë me prindërit e tyre. Që nga përfundimi i luftës kishin kaluar dy muaj dhe njëzetë e një ditë. ‘Përse ajo nuk buzëqesh?’ Vëllai im u caktua ta shuante qiririn me frymë. Të rriturit diskutonin për luftën dhe situatën politike. Për zotin Asquith dhe zotin Lloyd George. M'u kujtua një mbrëmje private ku zoti Asquith kishte pirë shumë. Ai ishte duke luajtur me letra, por në çastin kur i erdhi radha për t'i prerë ato, gabimisht ai u përpoq të priste një kuti të madhe me shkrepsë. Në një rast tjetër e kisha parë t'i hidhte krahun mbi supe një zonjë brenda një veture të markës Daimler, dhe përgjithësisht të sillej me të në një mënyrë tepër miqësore. Për çudi ajo tha: ‘Mjaft më me këtë marrëzi, do t'i them shoferit ta ndali makinën, mjaft, përndryshe do të zbres nga makina.’ Zoti Asquith u përgjigj: ‘Pash zotin, çfarë arsye do të japësh?’ Nejse, mua më kishte ardhur ora e ushqimit.

Të ftuarit për ditëlindjen time mbërritën. Ishte shumë e trishtueshme, u shpreh njëra prej grave e veshur me rroba të zeza, që Wilfred Owen-i u vra pikërisht para përfundimit të luftës, dhe me atë rast ajo citoi nga një poemat e tij:

Nuk u dashkan kambana për ata që vdesin si bagëti?

Por vetëm zemërimi i përbindshëm i topave që dëgjohet si ushtimë.

Fëmijët lëshonin piskama e çapiteshin nga të gjitha drejtimet. Njëri prej tyre ishte i sëmurë, një tjetër lagu dyshtemenë tek qëndronte në këmbë tek vështronte pellgun gojëhapur. Dyshemeja u fshi, ndërsa unë përplasa lugën me forcë mbi tavolinë.

Me Vdekjen unë kam lënë takim

Në një qytet nën flakërimë;

Kur pranvera sërish në veri të rimarrë një udhëtim,

Dhe fjalën e dhënë ta mbaj si një premtim,

Nuk ka sesi unë të mungoj në këtë takim.

Më shumë prindër dhe fëmijë erdhën për vizitë. Një burrë i shëndoshë që po ngrohte të ndenjurit pranë zjarrit tha: ‘Vazhdoj t'i mbetem besnik mendimit se fjalët e Asquith-it me rastin e armëpushimit ishin aq me vend...’

Kekun e ditëlindjes ma sollën pranë karriges së lartë ku isha ulur për të parë mirë; qiriri ndriçonte dhe regëtinte përmbi kremin ngjyrë trëndafili. ‘Sa keq që ajo nuk buzëqesh kurrë.’

‘Do të vijë edhe koha kur ajo do të buzëqeshë,’ tha mamaja dukshëm e tronditur.

‘Ajo që Asquith-i tha menjëherë pas luftës në Dhomën e Komunave,’ tha zotëria i shëndoshë me të ndenjurit nga zjarri, ‘ishte kaq me vend. Ai tha se lufta ka spastruar dhe ka larë të gjitha të këqijat e botës, falë zotit! Fjalët e tij i mbaj mend me saktësi: ‘Gjithçka është rinovuar. Në këtë larje dhe spastrim të madh vendi ynë pati privilegjin për ta luajtur rolin e vet...’

Kaq u desh. Unë shpërtheva në një buzëqeshje, të cilën të gjithë e vunë re, i bindur se ajo ishte provokuar nga fakti se vëllai im sapo kishte shuar qiririn e kekut të ditëlindjes. ‘Ajo buzëqeshi!’ thirri mamaja. Të gjithë filluan të kakarisnin për faktin që unë po buzëqeshja. Për më tepër unë klitha nga gëzimi si të isha një korb i çmendur. ‘Fëmija im po buzëqesh!’ thirri mamaja.

‘Merita është e qiririt të vendosur në kekun e ditëlindjes,’ u shprehën ata.

Mallkuar qoftë keku! Që atëherë kam filluar të buzëqesh krejtësisht natyrshëm, si çdo njeri tjetër që merr vesh nga punët e shtëpisë, por kur vërtet dua të buzëqesh, me një ndjenjë që më del nga thellësia e shpirtit dhe e parë nga të gjitha anët, mund të them se buzëqeshja më vjen si një reagim ndaj fjalëve të thëna në Dhomën e Komunave menjëherë pas Luftës së Parë Botërore nga burri i shquar dhe sqimatar, i ndjeri zoti Asquith.



CYNTHIA OZICK

FANTAZMA NË TRYEZËN E SHKRIMIT

Përktheu nga origjinali Granit Zela

Nëse shkrimtarët janë të padukshëm, kjo s'ka lidhje me famën, ashtu si fama s'ka të bëjë shumë me letërsinë. Fama e meriton të shkruhet me "F" të madhe ngaqë është fluturake, letërsia "L" të madhe sepse na lartëson gjithnjë. Aktorët, personazhet e famshëm televiziv dhe politikanët, fjalimet e të cilëve marrin lëvdatat e pafundme të publikut, shumë herë të stisura, mund ta arrijnë shpejt famën, por ajo është përherë produkt i kulturës së tanishme, asaj të ditës, pra kulturës kalimtare. Shkrimtarët janë ndryshe. Ajo që shkrimtarët çmojnë është njohja e vlerave letrare, diçka më e thjeshtë, më e pabujshme dhe më jetëgjatë se fama. Fama, në përgjithësi, përcaktohet nga rritjet e shitjeve në platformën e Amazon-it. Vlerësimi i pazhurmshëm dhe i natyrshëm për librin e shkruar bëhet nga lexuesi: autori i padukshëm është provë e vlerës së librit.

Pranimi i vlerave letrare mund të jetë proces i brishtë, si një dritë që fiket fare lehtë. Kujtoni keqardhjen e Henry James-it për botimin në Nju Jork të njëzetë e katër volumeve, me rishikimet e bëra dhe parathëniet e paçmuara: ishte vepër e madhe, e panjohur, e palexuar dhe e pashitur. E gjitha kjo ndryshoi në mënyrë tepër bujare. Banorët e Parnasit janë të shurdhër ndaj lajmeve tokësore pasi gjithçka ka ndodhur por nga vonesa s'vjen asgjë e mirë. S'ka asgjë më sprovuese ndaj vlerave të qëndrueshme letrare se sa vdekja: sa shpesh ndodh që një shkrimtar i cili sa është gjallë, lavdërohet, lartësohet, dekorohet, dhe pastaj lihet në hije pa kalaur as një ose dy vjet pas largimit nga jeta? Tashmë Norman Mailer-i është një zhurmë e largët që s'ngjall keqardhje, William Styron-i grimcë në largësi të mesme (frazë gati e harruar e Max Beerbohm-it e përdorur për Henry James-in që po zbehet). Mistiku i trullësuar Jack Kerouac ose Allen Ginsberg-u orator dhe ulëritës janë dëshmi të një epoke për të cilën interesohet

aradha e përhershme e historianëve shoqëror dhe profesorëve që ngazëlleen nga studimet kulturore.


Sidoqoftë, heshtja e papritur dhe mungesa e vëmendjes pas vdekjes, duhet të shihet e shkëputur nga heshtja ngaqë shumë shkrimtarëve të gjallë janë të detyruar të shkruajnë në gjuhët e pakicave, larg dritave që hedh mbi veprat e tyre lingua franca, ndërkohë që veprat shumë shpesh u mbeten të papërkthyer. Padukshmëria e shkrimtarëve të vdekur kohët e fundit është çështje e cila në disa raste mundet (do të isha i kënaqur të përmendja disa), të jetë lehtësues, por padukshmëria e shkrimtarëve të

gjallë është çështje krejt tjetër, me rëndësi thelbësore për vazhdimësinë letrare.

Shmangia politike e shkrimtarëve për t'i bërë të padukshëm dhe të padëgjueshëm është projekt shtypës që sjell si pasojë atë që mund të quhet padukshmëri publike, e rrënjësuar në rrethana të jashtme, tek paragjykimet e egra të gangsterëve që drejojnë regjime të kalburës, tek paragjykimet hakmarrëse të akademikëve të korruptuar që propozojnë bojkotime intelektuale, tek paragjykimet e cekëta të lordëve botues në gjuhët sot mbizotëruese, dhe së fundi (reductio ad absurdum!) tek paragjykimet ideologjike të ngushta të disa botuesve të revistave letrare. Të gjitha këto ndodhin në mënyrë të shfrenuar, skandaloze dhe shkatërruese. Por çfarë mund të thuhet për një padukshmëri vetjake, të brendshme, të ndjeshme dhe shumë më të përhapur?

Vladimir Nabokovi ishte dikur shkrimtar i padukshëm i cili vuante nga tre prej këtyre rrethanave të pafavorshme: padukshmëria nga publiku, padukshmëria vetjake dhe ajo gjuhësore. Si emigrant që u largua nga trazirat bolshevike dhe më vonë si refugjat që u largua nga nazistët, ai u shpëtoi dy tiranive më të mëdha të shekullit XX. Dhe si emigrant që shkruante në rusisht, në Berlin dhe Paris, mbeti i padukshëm gati për të gjithë, me përjashtim të bashkatdhetarëve në mërgim. Vetëm pasi vajti në Amerikë, termi diskriminues "emigrant" filloi të zhdukej, duke u zëvendësuar së pari me nocionin e qytetarit, dhe në fund fare me atë të shkrimtarit amerikan, sepse ndodhi që në Amerikë, nga i padukshëm Nabokovi jo vetëm u bë i dukshëm por edhe i pathyeshëm.

Por Brian Boyd, autori i biografisë intime dhe panoramike për Nabokovin, "Vitet amerikane të Nabokovit", rrëfen vështirësinë e bojës së



padukshme e cila kthehet në bojë të dukshme, jo vetëm në luftën e zgjatur për botimin e romanit “Lolita”, por edhe me revistat më liberale letrare. Ishte “New Yorker-i” i guximshëm i viteve 1950-të që s’pranoi të botonte një kapitull të “Pnin”, romanit që jepte kronikën e alter egos magjepsëse dhe vetë-parodiozuese të tij sepse sipas Boyd-it, “Nabokovi s’pranoi të heqë referencat për regjimin e Leninit dhe Stalinit, të gjitha historikisht të sakta”. (Frazat në fjalë përfshinin “torturat mesjetare në një burg sovjetik”, “diktatura bolshevike” dhe “padrejtësi e pashpresë”, të cilat redaktorët me sa duket i shihnin ose si të tepërta ose si gënjeshtër.) Sigurisht që kapitulli i përjashtuar politikisht s’e shmangu për shumë kohë padukshmërinë, dhe për sa i përket Lolitës, dekada pas ngadhënjimit të saj tronditës dhe të qëndrueshëm, ajo mori hov edhe një herë, në mënyrë të çuditshme, në kujtimet e admiruara të Azar Nafisi-t, i cili e lidhi fatin e Lolitës me mullahët e pamëshirshëm të Teheranit. (Edhe sot, edhe në New York, mund të gjesh një revistë të shquar liverare, e gatshme për të jetësuar përjashtimin për arsye politike të një shkrimtari, shembull i bojës zakonisht të dukshme, e cila kthehet në ndëshkim të padukshëm.)

Dhe këtu, më në fund është thelbi dhe paradoksi: shkrimtarët janë qenie të fshehta. Nuk e keni takuar kurrë një të tillë, dhe nëse ndonjëherë besoni se po shihni një shkrimtar, po diskutoni me një shkrimtar, po dëgjoni bisedën e një shkrimtari, të jeni të sigurt se e keni plotësisht gabim. Natyrisht, duhet të kujtojmë përsëri Henry James-in, i cili shumë kohë më parë e ka zhbiruar padurimin e padukshmërisë së shkrimtarëve. Në një histori të quajtur “Jeta private”, protagonistin, Clare Vawdrey, shkrimtar i ngarkuar me barrën e një prej këtyre emrave të veçantë që përdor James-i (ndoshta jo rastësisht emri në anglisht rimon me fjalën “tawdry”-i rëndomtë), është shkrimtar i dukshëm në çdo situatë të imagjinueshme shoqërore. Ai është përherë i gatshëm për një bisedë, shëtitje, për t’u takuar, i këndshëm, rrëfyes historish argëtuese, asnjëherë larg njerëzve ose i zënë me punë të tjera. Ka një dashuri mendjelehtë borgjeze: “Flet, qarkullon”, - na tregon rrëfimtari i James-it, “është jashtëzakonisht i popullarizuar, flirton me ty”. Veprat që shkruan, siç rëndom ndodh, janë krejt e kundërta e karakterit të tij të dukshëm, ajo përshkohet nga një madhështi e hallakatur. Një mbrëmje, ndërsa Vawdrey po pushon jashtë në tarracë, dhe po bën biseda të rëndomta me një shok, rrëfimtari hyn vjedhurazi në dhomën e Vawdrey-t për të zbuluar se ai në të vërtetë është i ulur në tryezën e shkrimit, në errësi, duke shkruar



si në ethe. Meqenëse është fizikisht e pamundur që një trup njerëzor të jetë në dy vende njëkohësisht, rrëfimtari arrin në përfundimin se Vawdrey shoqëror është një fantazmë, ndërsa shkrimtari që shkruan në errësi është Vawdrey i vërtetë. “Njëri është gjeni”, shpjegon ai, “tjetri është borgjezi dhe është vetëm borgjezi që ne njohim personalisht”.

Dhe që të mos e hedhim poshtë si një tjetër histori fantazmash të James-it, apo thjesht si parabolë komike, le të kujtojmë kredon e njohur Jamesian-e, shpallje të panikut vetjak e përzier me një intuitë të mprehtë, të cilën kaq shumë shkrimtarë e mbajnë fshehtas në tryezat e shkrimit: “Ne punojmë në errësi, bëjmë atë që mundemi, japim atë që kemi. Dyshimi ynë është pasioni ynë, dhe pasioni ynë është detyra jonë”. Shpallja përfundon në mënyrë të paharrueshme, “Pjesa tjetër është çmenduri e artit”.

Çmenduri e artit? Ndoshta po. Por ka më shumë të ngjarë të jetë logjika e padukshmërisë. Thënia e James-it ka dhe anën tjetër. Nuk është personaliteti shoqëror fantazma por shkrimtari i kërrusur mbi letër, përngjashmimin e mjegullt të të cilit s’do ta njohim kurrë personalisht, hija që fshihet në errësi ndërsa dytësori i tij i prekshëm shëtit jashtë, flet, qarkullon dhe ndonjëherë edhe flirton me shoqërinë. Rastet kur shihen këta shkrimtarë- fantazma janë të rralla dhe të pakta, të pabesueshme, por ekziston

një numër i vogël shfaqjesh të befta që mund të na udhëheqin, të paktën për pak, drejt një klasifikimi të duhur. Për shembull, një shkrimtar arrogant që kapardiset plot vetëbesim, përçmues në mënyrë agresive, i cili nënvlerëson dhe të shpërfill, çfarë është në të vërtetë? Kur e sheh fshehurazi përballë shkëlqimit të vetmuar të ekranit të kompjuterit, është thjesht një qenie e ndrojtur, e paralizuar nga ideja që së shpejti do të fillojë një fjalë të re. Dhe kjo krijesë shfaqësuese, lajkatare, e ndrojtur, e pasigurt dhe kundërshtuese, kur është e pushtuar nga pasioni i natës, ngjan me kaldajën e zjarrtë të një pushteti të pakundërshtueshëm dhe me siguri të jashtëzakonshëm. Shkrimtarët e vërtetë janë ata që kur po punojnë janë vetëm në manastirin e heshtur dhe instinktiv të vetmisë - fantazmë dhe asnjëherë ata që po bisedojnë me zell me ty në tarracë.

Cili është kuptimi i vërtetë i “çmendurisë së artit”? Të shtiresh sikur je dikush tjetër, duke shkërbyer, gënjyer, duke qenë i pavërteti dhe ti të besosh se kjo është shtirja, shkërbimi, gënjeshtër, e pavërteta e rrëfimit krijues. Jo, përkundrazi, arti e shndërron çmendurinë në ndjekje të fytyrës së rreme të shpërqendrimit të dëshiruar. Shkrimtari i pavërtetë është i dukshmi, kërkuesi i turmës, folësi i turmës, ai që do të hajë darkë me ty duke patur një motiv në mendje, do të jetë, të flasë dhe të diskutojë zakonet e të shkruarit me ty, ose thjesht të bëjë thashetheme për romancierët e tjerë dhe fatin e tyre për t’u pasur zili apo fatin e tyre të keq. Shkrimtari i pavërtetë është si Henderson-i, personazhi i Saul Bellow-t që përsërit gjithnjë: dua, dua, dua.

Nëse është kështu kështu, dhe kështu është, atëherë si mund të kërkojë një shkrimtar i ri të bëhet pjesë e të padukshmëve të zjarrtë shpirtërorë? Apo, e thënë në një mënyrë tjetër, megjithëse të gjithë shkrimtarët janë detyruar herë pas here të bëhen të dukshëm, si mund të ruhet një padukshmëri e mirëfilltë dhe e fshehtë kaq e lakmuar? A nuk synojnë të gjithë shkrimtarët e rinj të jenë në zonat e shikueshmërisë, ku marshojnë përpara falangat e zjarra të shkrimtarëve të vjetër dhe të rrëguar duke i bërë fresk vetes me recensa vlerësuese për ta? A nuk funksionon kështu, përmes modeleve dhe mentorëve dhe këshillave të mençura të redaktorëve me përvojë?

“Të lutem”, - thotë Rilke, duke iu drejtuar një shkrimtari të ri: “Të lutem hiq dorë nga gjithçka. Ti e sheh letërsinë nga jashtë, dhe nga të gjitha gjërat kjo është ajo që s’duhet të bësh tani. Askush s’mund të të këshillojë dhe s’mund të të ndihmojë askush. Ka vetëm një mënyrë: depërto brenda vetes. Zbulo motivin që të detyron të shkruash, hulumto nëse rrënjët e tij të shpien në skutat më të thella të zemrës, rrëfeji vetes nëse do të doje të vdisje nëse të ndalohej të shkruash. Para së gjithash, pyet veten në orën më të qetë të natës: a duhet se të shkruaj s’bën? Gërmo tek vetja për një përgjigje që vjen nga thellësia e qenies sate. Dhe nëse kjo përgjigje është pozitive, nëse mund t’i përgjigjesh kësaj pyetjeje solemne me një “duhet se s’bën”, të fortë dhe të thjeshtë, atëherë ndërtoje jetën sipas kësaj nevojë”.

Kështu, poeti Rilke, duke nënkuptuar që i riu i papërvojë duhet të shpërfill të gjitha shpërblimet e kësaj bote, bashkë me nxitjen, dhe ndonjëherë edhe iluzionin romantik të famës, ai kërkon që shkrimtari t’i përkushtohet një karriere më shpirtërore. Vini re se Rilke flet për “orën më të qetë të natës”, e cila është gjithashtu më e errëta, ora kur bëjmë atë që mundemi dhe japim atë që kemi: çmendurinë e artit, dhe përsëri dua ta kundërshtoj qëllimisht Henry James-in, nuk është tek arti, por tek turma e çmendur, fare e çmendur, vendi ku të gjitha llojet e dukshmërisë shtynë me bërëryla njëra-tjetrën, ndërsa fantazmat në tryezat e tyre të shkrimit ulen vetëm dhe shkruajnë, shkruajnë, shkruajnë, sikur prej saj të varej tejdukshmëria e nevojshme e shpirtit të tyre.



MODERNĚ KLASIKĚ 

VASILY
GROSSMAN

STALIN
GRADI

ROMAN



OMBRA GVG
DESIGN